

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5657
E mërkurë, 19 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Taksa dhe liberalizimi i vizave janë çështje të ndara

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

STUDENTËVE F. 12



Nga Bedri
ISLAMI

DEPUTETËT NË MITROVICË: PA NJOHJE NUK DO TË KETË MARRËVESHJE NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË F. 6

DEÇANASIT PARALAJMËRON PROTESTË NËSE VAZHDOHET NDËRPRERJA E RRYMËS F. 10

EKONOMI

MINISTRIA E BUJQËSISË, MBI 50 MILIONË EURO PËR BUJQËSINË NË VITIN 2019 F. 9

KOSOVA KA SHËNUAR PAK PËRPARIM NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT F. 8

KULTURË



LIBËR ME RËNDËSI TË VEÇANTË HISTORIKE F. 13

Habib MUSTAFA

SPORT

BEQIRI: MBIJETESA NUK DISKUTOHET, SYNOJMË KUPËN F. 18

PRISHTINA PËR FITORE NDAJ SZOLNOKI OLAJT F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA | FAQE 4-5

Kosova do të ketë pozitë më të fuqishme në finalen e dialogut

- Zhvillimet e fundit në Kosovë në raport me BE-në janë domethënëse



Ish-diplomati dhe profesori i së drejtës ndërkombëtare, Blerim Reka, i ka quajtur të dështuara përpjekjet e Serbisë për ta kundërshtuar formimin e ushtrisë së Kosovës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ai ka thënë se është i rëndësishëm qëndrimi pro ushtrisë së

Kosovës nga vendet anëtare të BE-së që janë anëtare në Këshill të Sigurimit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka theksuar se ka divergjencë në politikën e jashtme midis shteteve anëtare të BE-së që e përkrahin ushtrinë e Kosovës dhe një

burokrate të Brukselit që e kundërshton. Ai ka thënë se janë shumë domethënëse zhvillimet e fundit në Kosovë në raport me BE-në. Reka ka vlerësuar se formimi i ushtrisë dhe taksa ndaj Serbisë kanë demonstruar sovranitetin e shtetit të Kosovës

PRESIDENTI I SHBA-SË, DONALD TRUMP, I KA SHKRUAR LETËR PRESIDENTIT HASHIM THAÇI | FAQE 3

Trumpi: Liderët e Kosovës të jenë unikë për marrëveshjen historike me Serbinë



Presidenti amerikan Donald Trump ka ftuar liderët e Kosovës ta shfrytëzojnë këtë çast për të arritur një marrëveshje historike me Serbinë. Në një letër dërguar presidentit Hashim Thaçi, shefi i Shtëpisë së Bardhë ka vlerësuar se liderët e Kosovës në këtë fazë të

dialogut duhet të flasin me një zë të vetëm dhe të përmbahen nga veprimet të cilat mund ta vështirësojnë arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. Sipas presidentit Trump, dështimi për të përfituar nga kjo mundësi unike do të ishte një kthim tragjik mbrapa



Veseli nënshkruan ligjet për transformimin e FSK-së në ushtri | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Studentët nuk dorëzohen, vazhdojnë protestën

TIRANË, 18 DHJETOR - Studentët nuk tërhiqen nga protesta e tyre deri në plotësimin e tetë pikave të vendosura prej ditësh si kusht për qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama. Ndonëse herë në numër të madh e herë më pak, studentët

prej rreth dy javësh vazhdojnë me këmbëngulje protestat e tyre para dritares së kryeministrit Edi Rama.

Deri tani nuk ka pasur një përgjigje pozitive për dialog ndaj kryeministrit, megjithëse ai ka zhvilluar dy takime me

studentë e pedagogë në dy fakultete.

Sot (e mërkurë) studentët kanë paralajmëruar sërish bojkot të mësimit dhe nisjen e protestës në orën 10:00 te korpusi universitar. "Kauza në dorën e studentëve! Arsim cilësor, bashkëkohor,

fuqizues, për të gjithë dhe politika arsimore transparente dhe llogaridhënëse. Të mërkurën, studentët bojkotojnë mësimin dhe takohemi të gjithë te korpusi universitar në orën 10:00", thuhet në njoftimin e studentëve.



Haradinaj: Gjermania, partnere shumë e rëndësishme e Kosovës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim me zyrtarin e lartë gjerman Stephan Mayer, ka thënë se Gjermania është partnere shumë e rëndësishme e Kosovës, duke qenë mbështetëse e zhvillimit ekonomik dhe forcimit të shtetësisë së Kosovës



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim Stephan Mayer, sekretar parlamentar i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Gjermanisë. Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve si dhe për përkrahjen e Gjermanisë për

Kosovën. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar Mayerin për progresin në Kosovë dhe për prioritetet e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, proceset eurointegruese dhe për fuqizimin e tërësishtëm të shtetit.

Kryeministri Haradinaj ka përmendur edhe faktin se Kosova ka përbushur të gjitha kushtet

e vëna nga Bashkimi Evropian në procesin e liberalizimit të vizave. Ndër të tjera, kryemi-

nistri Haradinaj e ka falënderuar Mayerin për përkrahjen e madhe të Gjermanisë për

shtetin e Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke shprehur përkushtimin e Qeverisë për fuqizimin e partneritetit strategjik dhe të bashkëpunimit në shumë drejtime. "Gjermania është partnere shumë e rëndësishme e Kosovës duke qenë mbështetëse e zhvillimit ekonomik dhe forcimit të shtetësisë së Kosovës", ka thënë kryeministri Haradinaj. Po ashtu, në këtë takim u bisedua edhe për çështjet e tjera të rëndësishme për Kosovën, për dialogun Kosovë - Serbi, për proceset politike brenda Kosovës si dhe për perspektivën eurointegruese.

Sullivan: ShBA-ja mbështet integrimet euroatlantike të Maqedonisë

SHKUP, 18 DHJETOR - Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit, John Sullivan, i cili ka qëndruar për vizitë në Shkup, theksoi mbështetjen e fuqishme për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe në BE. Ai tha se ShBA-ja nuk befahet me përpjekjet ruse për minimin e synimeve të Maqedonisë drejt NATO-s. "Qeveria ruse mund të ndërmarrë çfarëdo lloj aktivitetesh për interesat e saj që ta minojë procesin", tha Sullivan.

Vizita e tij në Shkup shihet si vazhdimësi e mbështetjes amerikane për synimet e vendit të vogël ballkanik drejt integriteteve euroatlantike. Mbështetjen e rikon-



firmoi edhe vetë Sullivan. Por, Maqedonia së pari duhet ta miratojë ato që dalin si kushte nga Marrëveshja e Prespës me Greqinë fqinje. "ShBA-ja e mbështet

fuqimisht zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Prespës, e cila do t'i lejojë Maqedonisë ta zë vendin e duhur në NATO dhe në Bashkimin Evropian si Republika e Maqedonisë

së Veriut, duke i kontribuar qëndrueshmërisë rajonale, sigurisë dhe mirëqenies", tha Sullivan. "Ne jemi zotuar për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e Evropës Juglindore dhe Maqedonia është pjesa kyçe e kësaj qëndrueshmërie", tha zyrtari i lartë i Departamentit të Shtetit.

Sullivan tha se me krenari qëndron këtu në emër të ShBA-së në mbështetje të asaj që Qeveria e Maqedonisë dhe populli maqedonas e dëshiron, e që është anëtarësimi në NATO dhe në BE. Ai tha se ShBA-ja jep mbështetje por nuk e shtyn me forcë përpara Maqedoninë dhe se këto janë vendime të marra nën drejtimin e

guximshëm të kryeministrit. Sullivan tha se nuk është sekret qëndrimi rus kundër anëtarësimin të Maqedonisë në NATO. "Qeveria ruse mund të ndërmarrë çfarëdo lloj aktivitetesh për interesat e saj që të minojë atë çka populli i Maqedonisë dhe Qeveria e Maqedonisë kanë vendosur se është në interesin më të mirë të këtij vendi", tha Sullivan.

Ai ritheksoi qëndrimin amerikan për t'i qëndruar pranë Maqedonisë, ndërsa tha se "Qeveria ruse do të përdorë mjete të ndryshme për ta minuar procesin, siç ka vepruar në pjesë të tjera të Evropës por dhe në zgjedhjet amerikane të vitit 2016".

Basha: Mosveprimi i Prokurorisë, fundi i drejtësisë

TIRANË, 18 DHJETOR - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, edhe të martën ka mbështetur banorët e "Unazës së Re", nga ku ka deklaruar se do të këtë prova të reja për mënyrën se si ndryshoi plani urbanistik për t'i dhënë leje një të dënuari për trafik droge.

Basha shprehet se po shemben shtëpitë e banorëve, sepse kërkohet t'i mbulojnë vjedhjet e projekteve. "Mbështetje banorëve të

"Unazës së Re" në protestën e tyre të drejtë, për të mbrojtur shtëpitë nga megavjedhja 40 milionë euro e qeverisë", tha ai.

Po ashtu, lideri i opozitës deklaroi se do të këtë prova të reja që vërtetojnë përfshirjen në projekt të njerëzve me precedentë penalë. "Nesër para qytetarëve do të shpaloset me dokumente zyrtare se si, Erjon Veliaj ndryshoi planin urbanistik për t'i dhënë leje një

krimineli të dënuar me 21 vjet burg për trafik droge, Edmond Begos", tha Basha.

Ai shtoi se "për t'ua freskuar kujtesën qytetarëve, Edmond Bego është njeriu i cili në kundërshtim me ligjin, ndonëse i dënuar nga drejtësia italiane dhe vuajti një pjesë të dënimit këtu në Shqipëri, mori mbi 14 milionë euro tenderë në rrugën e Elbasanit, në zonën elektorale të Taulant Ballës, me të

cilin ka udhëtuar plot 57 herë jashtë shtetit në katër vitet e fundit".

Gjithashtu, Basha ka akuzuar Prokurorinë dhe Prokuroren e Përkohshme të Përgjithshme Arta Marku, se jo vetëm nuk po heton çështjen, por aludon se ajo mund të jetë përfshirë në afëra korruptive. "Këto ndërtesa do të shemben për të ndërtuar pallate shumëkatëshe nga një trafikant



droge. Mosveprimi i Prokurorisë tregon fundin e drejtësisë, por tregon se Arta Marku është bashkëfajtor dhe çdokush mund t'i akuzojë për përfshirje në afëra korruptive", tha Basha.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, i ka shkruar letër presidentit Hashim Thaçi

Trumpi: Liderët e Kosovës të jenë unikë për marrëveshjen historike me Serbinë

Presidenti amerikan Donald Trump ka ftuar liderët e Kosovës ta shfrytëzojnë këtë çast për të arritur një marrëveshje historike me Serbinë. Në një letër dërguar presidentit Hashim Thaçi, shefi i Shtëpisë së Bardhë ka vlerësuar se liderët e Kosovës në këtë fazë të dialogut duhet të flasin me një zë të vetëm dhe të përmbahen nga veprimet të cilat mund ta vështirësojnë arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. Sipas presidentit Trump, dështimi për të përfituar nga kjo mundësi unike do të ishte një kthim tragjik mbrapa



EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Presidenti amerikan Donald Trump i ka dërguar një letër presidentit Hashim Thaçi në të cilën konfirmon përkrahjen për Kosovën në procesin e dialogut me Serbinë. Presidenti Trump ka vlerësuar se mirëpret përpjekjet e Kosovës për pajtim me Serbinë, duke e inkurajuar presidentin Thaçi dhe liderët e tjerë të Kosovës që ta shfrytëzojnë këtë moment për mar-

rëveshje historike me Serbinë. "Ishte kënaqësi të flisja me ju në Paris gjatë shënimit të Ditës së Armëpushimit. Kosova është një partnere vendimtare në përpjekjet tona për ta garantuar paqen dhe stabilitetin për të gjithë Evropën. Unë i mirëpres përpjekjet tuaja aktuale për pajtim me Serbinë. Dështimi për të përfituar nga kjo mundësi unike do të ishte një kthim tragjik mbrapa, sepse një mundësi tjetër marrëveshje paqësore gjithëpërfshirëse, vështirë se do të mund të


përsëritet për një kohë të gjatë", është thënë në letrën e presidentit amerikan.

I pari i Shtëpisë së Bardhë ka ftuar liderët në Kosovë që të flasin me një zë në këtë proces dhe të mos bëjnë veprime për ta penguar marrëveshjen. "Unë ju nxis juve dhe liderët e Kosovës që ta shfrytëzoni këtë çast unik, të flisni me një zë të vetëm gjatë negociatave për paqe dhe të përmbaheni nga veprimet të cilat mund ta vështirësojnë arritjen e marrëveshjes. Shtetet e Bashkuara kanë investuar shumë për suksesin e Kosovës, si një shtet i pavarur dhe sovran. Ne duam që vendi juaj të vazhdojë të zhvillohet", është thënë në letrën e presidentit Trump, duke shtuar se ShBA-ja është e gatshme ta ndihmojë Kosovën në këtë proces. "Ne jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë në përpjekjet tuaja për të arritur një marrëveshje e cila reflekton në mënyrë të balancuar interesat e Kosovës dhe të Serbisë. Një marrëveshje e tillë është e arritshme. Unë pres që në Shtëpinë e Bardhë t'ju mirëpres juve dhe presidentin Aleksander Vuçiq për të festuar atë që do të jetë një marrëveshje historike", ka përfunduar letrën presidenti Trump.

Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili e ka postuar këtë letër në profilin e vet në "Facebook", ka shkruar se liria dhe pavarësia e Kosovës janë rezultat i luftës sonë të drejtë dhe përkrahjes së aleatëve tanë strategjikë ndërkombëtarë. "Realizimi i synimeve tona për anëtarësim në NATO, BE dhe OKB është i pamundur pa përkrahjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Kosova është e bekuar që gëzon mbështetjen e palëkundur të ShBA-së dhe të popullit amerikan. Bashkëpunimi dhe miqësia jonë është e përherëshme dhe reciproke. Mirëpo, ne duhet të dimë ta ruajmë dhe ta forcojmë këtë partneritet që kemi. Respekti dhe ndihma duhet të jenë reciproke dhe jo të njëanshme", ka shkruar Thaçi. Sipas tij, lidhshipi kosovar duhet t'i përgjigjet pozitivisht kësaj thirrje të presidentit amerikan. "Prandaj, është detyrim yni që t'u përgjigjemi pozitivisht thirrjeve dhe kërkesave miqësore që vijnë nga ShBA-ja. Një kërkesë e tillë miqësore, në të njëjtën kohë shumë serioze, më është bërë drejtpërsëdrejti nga presidenti i ShBA-së, Donald Trump. Në këtë letër presidenti Trump, ndër të tjera, kërkon nga unë

dhe liderët e Kosovës që ta shfrytëzojmë këtë çast unik, që të flasim me një zë, me qëllim të arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë", ka shkruar presidenti Thaçi.

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, letrën e presidentit amerikan e ka parë si ftesë për unifikim të spektrit politik vendor. Në profilin e vet në "Facebook", Murati ka shkruar se kjo letër shtrou rrugën për përfshirjen e ShBA-ve në procesin e dialogut. "Letra e presidentit Trump për presidentin Thaçi shtrou rrugën për përfshirjen e thellë të ShBA-së në procesin e dialogut. Është koha që t'i lëmë ngurtësitë e panevojshme, të bëhemi unikë, vizionarë dhe të shtrojmë për zgjidhje drejt e mirë, njëherë e përgjithmonë, me reciprocitet, çështjen e Kosovës Lindore me atë të tri komunave në veri të Kosovës. Ta shfrytëzojmë rastin historik për t'i hequr kufizimet e Pakos së Ahtisaarit në Kushtetutën e Kosovës (privilegjet bllokuese të pakicës serbe) dhe për ta bërë Kosovën një shtet funksional dhe sovran në tërë territorin e saj me standardet më të larta për të drejtat e pakicave, por jo më me privilegje bllokuese", ka shkruar Murati.



Veseli nënshkruan ligjet për transformimin e FSK-së në ushtri

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nënshkruar të martën ligjet për transformimin e FSK-së në ushtri. Përmes një postimi në llogarinë e vet

në "Facebook", kryeparlamentari Veseli ka thënë se ky ishte një nga nënshkrimet më të mira dhe më të vlefshme. "Me një ndjenjë të veçantë, sot nënshkrova ligjet për trans-

formimin e FSK-së në ushtri. Ky ishte një prej nënshkrimeve më të mira dhe më të vlefshme", ka shkruar Veseli. Kuvendi i Kosovës ka votuar ligjet për transformimin

e FSK-së më 14 dhjetor. Formimi i Ushtrisë ka marrë përkrahje të madhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e, po ashtu, edhe nga shtetet e tjera mike të Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

Kosova do të ketë pozitë më të

- Zhvillimet e fundit në Kosovë në raport me BE-në janë domethënëse

Ish-diplomati dhe profesori i së drejtës ndërkombëtare, Blerim Reka, i ka quajtur të dështuara përpjekjet e Serbisë për ta kundërshtuar formimin e ushtrisë së Kosovës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ai ka thënë se është i rëndësishëm qëndrimi pro ushtrisë së Kosovës nga vendet anëtare të BE-së që janë anëtare në Këshill të Sigurimit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka theksuar se ka divergjencë në politikën e jashtme midis shteteve anëtare të BE-së që e përkrahin ushtrinë e Kosovës dhe një burokrate të Brukselit që e kundërshton. Ai ka thënë se janë shumë domethënëse zhvillimet e fundit në Kosovë në raport me BE-në. Reka ka vlerësuar se formimi i ushtrisë dhe taksa ndaj Serbisë kanë demonstruar sovranitetin e shtetit të Kosovës



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 DHJETOR -

"Epoka e re": Profesor, si e keni parë debatin e fundit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së lidhur me vendimin e Kosovës për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri?

Reka: Debati i së hënës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së

ishte edhe një tentim i pasuksesshëm i Serbisë për ta rikthyer Rusinë në vendimmarrjen e Kombeve të Bashkuara ndaj Kosovës. Një tentim i ngjashëm i Serbisë në vitin 2010 përfundoi me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare publike. Edhe të hënën, përveç Ruisë dhe satelitëve të saj, u pa qartë

se në Këshill të Sigurimit as Rezoluta 1244 në të cilën thirrej përfaqësuesi rus nuk e ndaloi formimin e ushtrisë së Kosovës. Në logjikën juridike është e njohur se çdo gjë që nuk është e ndaluar me ligj, është e lejuar. Nëse në rezolutë nuk ka referencë për ushtrinë dhe nuk ka referencë as për ndalimin e formimit të ushtrisë, atëherë i tërë diskutimi që u bë në Këshill vetvetiu dështoi. Nga ana tjetër,

mund të themi se vetë Rezoluta 1244 në të cilën thirret në vazhdimësi Rusia është një relik virtual i një kohe të kaluar. Pra, ka një afat të skadimit, sepse tash e 17 vjet nuk ekziston as e ashtuquajtura RFJ dhe tash e 12 vjet nuk ekziston as pasardhësi i saj, i ashtuquajtur Union Serbi dhe Mal i Zi. Ndërsa tash e tetë vjet organi gjyqësor i OKB-së, GJND-ja e tha qartë se pavarësia e Kosovës ishte

ndërkombëtarisht legale. E rëndësishme në Këshillin e Sigurimit ishte qëndrimi pro ushtrisë së Kosovës nga anëtarët e BE-së që janë anëtarë në KS të cilët e përkrahën të njëjtën ditë ushtrinë e Kosovës, ndonëse ajo e cila paguhet nga buxhetet e shteteve anëtare, përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, në Bruksel e kundërshtoi formimin e ushtrisë së Kosovës. Me fjalë të tjera, kjo flet

fuqishme në finalen e dialogut

dhe shteteve të cilat e kritikuan Kosovën për formimin e ushtrisë, siç thuhej 'për hapa unilaterale', mirëpo vetë institucionet që e quajnë vetën multilaterale, OKB-ja, BE-ja, UNESCO dhe Interpoli, tash e sa vjet aplikojnë pikërisht një qasje unilaterale kundër Kosovës. OKB-ja po mbetet peng i politikës unilaterale të Rusisë kundër anëtarësimit të Kosovës dhe e përdorur të drejtën e vetos në KS. BE-ja është peng i vendimeve unilaterale të pesë shteteve anëtare që po pengon njohjen kolektive të Kosovës nga Bashkimi Evropian. Sikurse Interpoli, edhe UNESCO tash e sa vite është peng i unilaterizimit të shteteve të caktuara që votojnë kundër anëtarësimit të Kosovës. Tash kush është unilaterale? A është Kosova e cila në organin e vet më të lartë legjislativ vendos për një të drejtë sovranë dhe të natyrshme çfarë është mbrojtja e kufirit, territoreve dhe sovranitetit përmes ushtrisë apo janë organizatat multilaterale të cilat, në vend të vendimeve multilaterale, po e bllokojnë Kosovën me vendime unilaterale.

"Epoka e re": Z. Reka, kohën e fundit kryeministri Ramush Haradinaj ua ka bërë të qartë zyrtarëve të Bashkimit Evropian se nuk po e trajton si duhet Kosovën dhe nuk po e shpërblen për përmeshjen e kriterëve për liberalizimin e vizave. Si e komentoni ndryshimin e qasjes së shtetit të Kosovës ndaj Bashkimit Evropian?

Reka: Që nga fillimi marrëdhëniet Kosovë - BE kanë qenë marrëdhënie jashtë kornizës së marrëdhënieve normale kontraktuese të BE-së me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kur e them këtë kam parasysh se ishin marrëdhënie jonormale dhe marrëdhënie asimetrike të cilat mund të analizohen në dy rrafshë: në rrafshin politik dhe në atë teknik. Në rrafshin politik mosnjohja nga pesë vendet anëtare diferencoi edhe vetë politikat e Brukselit varësisht nga ajo se cili institucion merrte qëndrim. Në mungesë të konsensusit të 28 shteteve, Këshilli Evropian si institucion më i lartë vendimmarrës nuk e njohu Republikën e Kosovës. Ndërsa dy institucionet e tjera komunitare, ku shtetet anëtare kanë pak ndikim, Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian, patën një qëndrim tjetër. Madje Parlamenti Evropian përmes disa rezolutave tash e sa vjet kërkon që edhe këto pesë shtete ta njohin Kosovën. Kurse Komisioni

Evropian nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit me Kosovën. Por jashtë këtij diskursi dhe qëndrimi politik të BE-së është bren-gosëse se BE-ja ishte shumë e rezervuar edhe në çështjet teknike siç është liberalizimi i vizave. Kosova plot gjashtë vjet punoi për përmeshjen e kriterëve 95 sosh, mirëpo as kjo nuk mjaftoi në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave të Brendshëm, ku Holanda dhe Belgjika konsideruan se ende ka punë për Kosovën, sidomos për luftimin e korrupsionit, të të ashtuquajturve peshq të mëdhenj dhe krimet të organizuar. BE-ja i hoqi vizat Moldavisë, Ukrainës e Gjeorgjisë të cilat nuk janë në procesin e zgjerimit të BE-së e, në fakt, Kosova është pjesë e këtij procesi. Që të tri shtetet janë në nivelin më të lartë të korrupsionit dhe në njërin prej këtyre shteteve brenda një muaji u zhdukën një miliard dollarë amerikanë. Ndaj shtetit tjetër muajin e kaluar vetë BE-ja i ndaloi 130 milionë euro fonde dedikuar reformave për shkak të pakënaqësisë për procesin e reformave. BE-ja ua ka hequr vizat edhe disa shteteve që janë jashtë kontinentit evropian, kurse e mbajnë Kosovën në geto. Nuk them se situata në Kosovë është e shkëlqyeshme dhe ka nevojë për një luftë dhe betejë kundër korrupsionit institucional. Nuk besoj se do të jetë i saktë parashikimi i komisionarit Hahn se nuk mund të pritët liberalizimi i vizave deri në vitin 2020. Mendoj se do të ketë liberalizim më herët.

"Epoka e re": Të hënën Mogherini, të paktën për t'u shfaqësuar, ka thënë se liberalizimi i vizave është duke u shqyrtuar në Këshillin e Ministrave. Pas zhvillimeve të fundit, duket se BE-ja ka filluar ta shohë si palë më serioze Kosovën.

Reka: E kuptoj pesëmujorin e fundit të mandateve të zyrtarëve të Komisionit Evropian sepse zgjedhjet do të jenë në maj të vitit të ardhshëm dhe në vjeshtë do të kemi një komision me komisionar të ri të BE-së. Për mua janë shumë domethënëse disa zhvillime që ndodhen në Kosovë gjatë këtyre dy muajve të fundit në raport me BE-në. Duke e parë qasjen nihiliste të BE-së ndaj Kosovës si në rrafshin politik dhe në atë teknik, duke parë se Serbia është përfutjesja e vetme e dialogut e cila nga statusi i kandidatit i hapi negociatat për anëtarësim, madje disa edhe i ka mbyllur, Kosova mezi kaloi fazën elementare të nënshkrim-

it të MSA-së, por jo edhe të liberalizimit të vizave. Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa hapa për ta demonstruar edhe faktikisht sovranitetin de jure që e ka me Kushtetutë në dy rrafshë: në rrafshin ekonomik me aplikimin e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës dhe në rrafshin e sovranitetit mbrojtës me formimin e ushtrisë.

"Epoka e re": Madje Kosova ka ndryshuar qasjen edhe karshi dialogut me Serbinë. Pas këtyre zhvillimeve dhe pas miratimit të rezolutës dhe formimit të ekipit negociator, si e shihni vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi?

Reka: Në fazën e finalizimit të dialogut të Brukselit Kosova do të ulet në tavolinë me një pozitë më të fuqishme negociatore. Pra, ka për çfarë të diskutojë tash me Serbinë. Deri më tani vetëm Serbia ka kërkuar lëshime nga Kosova, tash do të jetë një proces i kundërt dhe Serbia do të merret me dy aktet e fundit të sovranizimit të shtetit të Kosovës, me aktin e sovranizimit ekonomik dhe ushtarak si dhe do ta ketë përballë një palë që nuk mund të injorohet. Masa e sovranizimit ekonomik dhe ushtarak të Qeverisë së Kosovës, hartimi i shkëlqyeshëm së draft-ligjit për zhvillimin e negociatave, kalimi i mandatit për vendimmarrje për procesin e negociatave në Kuvendin e Kosovës si dhe formimi i ekipit negociator udhëzojnë që Kosova në këtë fazë finale të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë do të jetë në një pozitë tjetër negociuese. Në çdo shtet sovran parlamentet janë ato që hartojnë platformën negociatore, që i japin mandat ekzekutivit i cili i përpunon strategjitë negociatore dhe formon ekipin negociator që i jep llogari Kuvendit të Kosovës për procesin e negociatave. Kjo deri tash ka munguar në këta 7-8 vjet të negociimit me Beogradin dhe, si duket, po rikthehet procesi në një adresë të paevitueshme siç është Kuvendi i Kosovës si organ më i lartë politik dhe përfaqësues. Në një mënyrë, me miratimin e rezolutës dhe me mandatin e qartë të Kuvendit procesi i dialogut bëhet më transparent, më llogaridhënëse dhe ngrihet niveli i përgjegjësisë për atë se çka bisedohet. Ka pasur fare pak raportime në Kuvendin e Kosovës për ecurinë e negociatave të gjertanishme. Shpresoj se adresa e vetme ku do të jepet viza për hapat e më tutjeshëm të negociatave do të jetë Kuvendi i Kosovës.

për një divergjencë në politikën e jashtme midis shteteve anëtare që e përkrahin ushtrinë e Kosovës dhe një burokrate të Brukselit që u deklarua kundër.

"Epoka e re": Në një farë mënyre KS i OKB-së e legjitimoi formimin e ushtrisë së Kosovës?
Reka: Me vetë faktin që nuk arriti të kalojë versioni i draftrezolutës së përgatitur nga Rusia me iniciativën e Serbisë me një konkluzë

apo një ndalesë decisive, kjo u pa se edhe ky tentim i Serbisë dështoi në KS të OKB-së.

"Epoka e re": ShBA-ja dhe shumica e vendeve evropiane e përkrahën formimin e ushtrisë, por jo edhe BE-ja e NATO-ja të cilat në vazhdimësi po e quajnë jo të duhur transformimin e FSK-së.

Reka: Është e vërtetë se ka pasur reagime të disa institucioneve

Deputetët në Mitrovicë: Pa njohje nuk do të ketë marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë



Deputetë të partive të ndryshme kanë marrë pjesë të martën në një tryezë diskutimi në rajonin e Mitrovicës, në të cilën është diskutuar për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi, për votimin e rezolutës nga ana e Kuvendit për këtë proces dhe për formimin e ekipit negociator

EPOKA E FATON DËRMAKU

MITROVICË, 18 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar të martën një tryezë diskutimi në rajonin e Mitrovicës në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës: Blerta Deliu-Kodra, Glauk Konjufca, Dukagjin Gorani, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Jeta Krasniqi nga KDI-ja në hapje të këtij takimi ka treguar lidhur me rëndësinë dhe simbolikën e mbajtjes së këtij takimi pikërisht në Koshtovë, duke qenë se, sipas saj, marrëveshjet e deritanishme që janë arritur në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi kanë prekur më së shumti

banorët e kësaj zone. Ajo ka shtuar se KDI-ja në vazhdimësi ka organizuar takime të tilla ndërmjet qytetarëve dhe deputetëve të Kuvendit, duke synuar gjithëpërfshirje, transparencë dhe llogaridhënie të këtij procesi.

Gjatë adresimeve hyrëse, deputetja Blerta Deliu-Kodra ka vlerësuar se miratimi i rezolutës lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi reflekton arritjen e një konsensusi të partive në pozitë dhe opozitë për një temë të rëndësishme të lartë shtetërore. "Kjo rezolutë ka kodifikuar rolin qendror të Kuvendit në këtë proces si organ përfundimtar për mbikëqyrjen e këtij procesi si dhe ratifikimin e marrëveshjes eventuale", ka thënë ajo.

Deputetja Kodra-Deliu ka ftuar

partitë opozitare që t'i marrin përgjegjësitë institucionale, duke u bërë pjesë e dialogut meqë, sipas saj, ikja nga përgjegjësia nuk u bënë nder as qytetarëve, por as klasës politike. Shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se nevoja për konsensus ka degraduar në një klishe universale. Sipas tij, më i rëndësishëm se arritja e konsensusit është përmbajtja dhe kualiteti i procesit. Konjufca ka vlerësuar se ata nuk pajtohen me qëndrimin e pushtetit lidhur me këtë proces dhe se Kosova që nga qershori i vitit 2008 ka humbur në vazhdimësi nga proceset të cilat e kanë sfiduar shtetësinë e Kosovës.

Dukagjin Gorani nga grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate u përgjigj në pyetjen se çfarë paralajmëron faza e re e dialogut, duke thënë se në këtë fazë pritet të përmbillet një proces i mundimshëm i një konflikti të ngrirë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, sot ekziston një presion i madh kohor dhe kalendarik që ushtrohet nga bashkësia ndërkombëtare, që marrëveshja përfundimtare

mes Kosovës dhe Serbisë të arrihet deri në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm. Ai ka deklaruar se do të ketë diskutime lidhur me rreth dymbëdhjetë tema, por që nuk do të ketë marrëveshje për asnjërën nga këto tema pa njohjen formale të Kosovës nga ana e Serbisë. Kurse, në rast të dështimit për arritjen e një marrëveshje të tillë, Gorani ka thënë se humbës do të jenë shoqëritë e dy vendeve.

Në këtë proces, sipas tij, diskutimet duhet të zhvillohen në frymën se çfarë është e pranueshme për ne dhe jo vetëm çfarë ne kundërshtojmë. Deputeti i AAK-së, Ahmet Isufi, ka thënë se draftmarrëveshja e paraqitur nga kryeministri Haradinaj ka gjithsej 16 kapituj, të cilët do të diskutohen si tema gjatë bisedimeve.

Isufi nuk ka përjashtuar mundësinë e ndryshimeve eventuale kushtetuese që mund të vijnë si rezultat i kësaj faze të dialogut. Sa i përket mundësisë së shkëmbimit të territoreve, ai ka përjashtuar këtë opsion, duke thënë se epilogu i vetëm i këtij procesi është njohja e Kosovës në kufijtë aktualë.

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka konstatuar se të gjitha partitë politike në Kosovë janë kundër opsionit të ndarjes. Ai ka shtuar se do të ishte e dëshirueshme që rolin e njëjtë me PSD-në ta marrë edhe LDK-ja dhe LV-ja pasi që procesi i dialogut është i pashmangshëm. Lidhur me rezolutën e miratuar, Sherifi ka theksuar se dizajnimi i përfaqësimit në dialog është një lloj triumvirati mes pozitës, opozitës dhe presidentit të vendit, duke pamundësuar rolin dominues të ndonjëres palë. Ai ka shprehur besimin në ekipin negociator për arritjen e një traktati ligjërish obligues, që do t'i hapë rrugë Kosovës drejt anëtarësimit në mekanizmat ndërkombëtarë, duke shtuar se rezultat i vetëm i bisedimeve duhet të jetë njohja reciproke mes dy vendeve.

Ndërsa qytetarët ngrehën shqetësimet e tyre lidhur me çështjen e kthimit të shqiptarëve në pronat e tyre në veri, përfaqësimin e interesave të shqiptarëve të veriut në dialog dhe kushteve më të mira të jetesës.

Pacolli dhe ambasadori japonez diskutojnë për bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka pritur të martën në një takim të rregullt pune ambasadorin jorezident të Japonisë në Kosovë, Kiyoshi Koinuma.

Në kuadër të këtij takimi është diskutuar në lidhje me zhvillimet e fundit politike në vend, ndërkohë që vëmendje e posaçme i është kushtuar avancimit të marrëdhënieve

dypalëshe në mes dy vendeve. Për qëllimin e njëjtë, ministri Pacolli dhe ambasadori japonez Koinuma kanë diskutuar në lidhje me organizimin e ceremonisë për shënimin e dhjetëvjetorit të marrëdhënieve diplomatike në mes dy vendeve në fillim të vitit të ardhshëm dhe, po ashtu, organizimin e një forumi ekonomik në mes dy vendeve, që pritet të mbahet në gjashtëmuorin e parë të vitit 2019.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Taksa dhe liberalizimi i vizave janë çështje të ndara

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se taksa prej 100 përqindësh për mallrat serbe nuk është e ndërlidhur me procesin e liberalizimit të vizave. Për këtë të fundit, ai shpreson se do të ndodhë në një të ardhme jo të largët. Sipas Haradinajt, liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës nuk do të shkojë aq larg sa kishte thënë komisionari Hahn gjatë vizitës së fundit në Prishtinë

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se taksa e vendosur për mallrat serbe dhe procesi i liberalizimit të vizave janë çështje të ndara. Në një konferencë për media, pas mbledhjes së Qeverisë, Haradinaj ka thënë se Kosova ka dy kërkesa për BE-në: normalizimin e dialogut të Brukselit dhe liberalizimin e vizave. "Për BE-në i kemi dy kërkesa që janë legjitime: normalizimi i dialogut, sepse ka dalë nga kontrolli apo normaliteti dhe liberalizimi i vizave. Të dyja këto janë në proces, pra edhe liberalizimi i vizave. Kjo nuk ndërlidhet me taksën. Është një kontratë e ndarë që ka pasur Kosova me BE-në dhe nuk ndërlidhet me taksën", është shprehur Haradinaj. Ai ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave do të ndodhë më shpejt sesa ka deklaruar komisionari Hahn kur vizitoi Prishtinën. "Është e drejtë e qytetarëve të vendit, po ashtu edhe si palë kontraktuese e kemi kryer pjesën tonë. Besoj se do ta marrim liberalizimin e vizave në një të ardhme jo fort të largët. Të paktën jo atë që e ka thënë komisionari Hahn në Prishtinë,

pra ne po synojmë për të marrë tash liberalizimin para vitit të ri. Kjo është një e drejtë e jona, por edhe një herë po e përsëris se nuk ndërlidhet me taksën", është shprehur kryeministri.

Ai ka bërë me dije se Kosova është e gatshme qysh tash ta heqë taksën për mallrat serbe nëse plotësohen kushtet e kërkuara. "Ne kemi nevojë dhe interes për të na njohur Serbia për shkak se i dështon proceset tona integruese dhe perspektivën tonë. Sido që të jetë, edhe Serbia ka interes për diçka, që është tregu i Kosovës, një treg lehtë i arritshëm. Nëse ata janë të gatshëm sot, ne sot merremi vesh dhe hiqet taksa", është shprehur Haradinaj. Ai ka folur edhe për shefen e politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini. "Znj. Mogherini është e ngarkuar me dialogun, por ju e dini se dialogu nuk është duke sjell rezultate. Gati se i ka rrezikuar të arriturat në Ballkan të Evropës dhe Amerikës në paqe, në stabilitet dhe në normalizim. Pozicioni im ka qenë i sinqertë, e çmoj atë shumë edhe si njeri, edhe si zyrtarë e BE-së. Pozicionimi im ndaj saj është shumë i qartë, që mos na rrezikoni më tutje, normalizoni dialogun, sepse po i rrezikoni krejt të arriturat e BE-së dhe të Amerikës në Ballkan", është shprehur kryeministri Haradinaj.



Qeveria diskuton për draftmarrëveshjen gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka shqyrtuar draftmarrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes së cilës palët pajtohen të marrin detyrime nga kushtet e kësaj marrëveshje. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka informuar kabinetin qeveritar për draftmarrëveshjen, duke thënë se dialogu në mes të dy shteteve ka kaluar nëpër disa faza. Sipas tij, nga data 15 dhjetor 2018 ky proces ka një zhvillim të ri, pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar rezolutën mbi procesin e dialogut ku, po ashtu, përcaktohet edhe delegacioni i Kosovës në këtë dialog, i përbërë nga pozita dhe

opozita si dhe shoqëria civile. "Synimi ynë është të arrijmë një kontratë përfundimtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizim të marrëdhënieve", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se pjesë e dialogut nuk do të jetë statusi i Kosovës, pasi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka dhënë vendimin, që nuk ka shkelje të së drejtës ndërkombëtare me shpalljen e pavarësisë dhe kjo çështje tashmë është e mbyllur; pjesë e dialogut nuk do të jenë as kufijtë e Kosovës; tarifa që është vendosur prej 100 përqindësh ndaj mallrave të Republikës së Serbisë, do të qëndrojë deri në arritjen e njohjes nga Serbia.

Shefi i delegacionit të Kosovës për bisedime teknike, Avni Arifi, ka dhënë një informatë të detajuar të kësaj draftmarrëveshje, duke theksuar se vendimi i tyre është që të mos hapen tema të tjera, por të përmbillen vetëm ato ekzistueset dhe të fillojë implementimi i tyre. "Ne kemi pasur tri takime në Bruksel. Fatkeqësisht, pala serbe nuk ka treguar as vullnetin minimal për zbatimin e asnjë marrëveshje", ka thënë Arifi, duke shtuar se më 18 qershor 2018 në Bruksel janë prezantuar para anëtarëve të COWEB-it dhe të vendeve anëtare të BE-së të arriturat e tyre në atë takim.

KDI dhe D4D: Emërimi i anëtarëve të KQZ-së të bëhet në bazë të dispozitave ligjore

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) kanë njoftuar se janë duke përcjell me vëmendje procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). "Pas papranueshmërisë së kërkesës së presidentit Thaçi për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e Gjykatës Kushtetuese, Zyra e Presidentit ka filluar dërgimin e kërkesave për nominim të anëtarëve të rinj të KQZ-së nga grupet parlamentare. Megjithatë, nga informatat e siguruar nga terreni dhe nga mediet, KDI dhe D4D konsideron që Zyra e



Presidentit është duke shfaqur tendencë për të vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Çdo përpjekje tjetër për t'i tejkuluar dispozitat ligjore në fuqi ndikon negativisht në integritetin e

zgjedhjeve dhe ka implikime në të gjitha fazat e procesit zgjedhor", është bërë me dije në njoftimin për media të këtyre dy organizatave. Sipas Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe Institutit Demokracia për Zhvillim (D4D),

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmes nenit 139, paragrafi 4, e rregullon përbërjen e KQZ-së, ku konstaton se gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuar në Kuvend. "Një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë", është theksuar në këtë njoftim. KDI dhe D4D ka vlerësuar se duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe rezultatin nga zgjedhjet parlamentare në vitin 2017, 11 vendet e KQZ-së duhet

të shpërndahen si vijon: Koalicioni PAN, Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së u takojnë nga dy anëtarë, grupeve parlamentare që përfaqësojnë komunitetet joshumicë u takojnë katër (4) anëtarë dhe një (1) vend për kryetaren e KQZ-së. Çdo interpretim tjetër për përbërjen e KQZ-së është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

KDI dhe D4D konsiderojnë se funksionalizimi i KQZ-së duhet të trajtohet me prioritet nga presidenti, në mënyrë që t'i përmbushë obligimet e saj e aq më tepër kur disa nga anëtarët e KQZ-së vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit përkundër mosfunksionimit të këtij institucioni.

Kosova ka shënuar pak progres në luftimin e korrupsionit

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Korrupsioni vazhdon të mbetet ndër pengesat kryesore në zhvillimin e aktiviteteve biznesore të ndërmarrjeve në Kosovë ashtu edhe në përditshmërinë e qytetarëve. Kjo është thënë të martën gjatë tryezës së organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbi rëndësinë e luftimit të korrupsionit në vend.

Arian Zeka, drejtor ekzekutiv i Odës Amerikane, ka thënë se korrupsioni duhet të luftohet për të arritur një zhvillim të mirëfilltë ekonomik dhe krijim të një imazhi më pozitiv të Kosovës. Ai ka thënë se nëpërmjet studimit të zhvilluar nga Oda Amerikane mbi perceptimin e korrupsionit 75 për qind e bizneseve e shohin korrupsionin si sistematik, duke shtuar se faktorët të cilët kryesisht ndikojnë në rritjen e korrupsionit janë sundimi i dobët i ligjit si dhe

mosfunksionimi i duhur i gjykatave për luftimin e kësaj dukurie. Ndërsa Brian Martalus, drejtor i Zyrës për Rritje Ekonomike në USAID, ka thënë se për t'u luftuar korrupsioni në mënyrë sa më efektive rregullat dhe ligjet në fuqi duhet të zbatohen. Ai ka thënë se Kosova ka potencial të madh për të luftuar këtë dukuri duke thënë se ende ka nevojë të punohet në këtë drejtim.

Ndërsa Hasan Preteni nga Qendra për Etikë, Transparencë dhe Integritet ka deklaruar se Kosova ka shënuar mjaft pak progres në luftimin e korrupsionit. Ai ka thënë se, pavarësisht prej hyrjes në fuqi të ligjeve në kuadër të luftimit të korrupsionit, ende hasim në vështirësi në zbatimin e tyre.

Më tutje, Blerim Kelmendi nga Agjencia Kundër Korrupsionit ka theksuar se situata në Kosovë në këtë aspekt ka ende hapësirë për përmirësim. Ai ka thënë se, përveç pranimit të raportimeve të rasteve të korrupsionit nga



ana e qytetarëve dhe bizneseve, ky institucion ka punuar për identifikimin dhe luftimin e

rasteve korruptive në mesin e shoqërisë kosovare duke shtuar, mes të tjerash, si të rëndësishme

primare luftimin e kësaj dukurie dhe angazhimin e institucioneve relevante në këtë drejtim.

ATK-ja për periudhën janar-nëntor ka inkasuar 421 milionë euro



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Administrata Tatimore e Kosovës

(ATK), duke pasur parasysh bashkëpunimin dhe mbështetjen e deritanishme nga donatorët dhe nga palët e interesit, të martën ka mbajtur takimin

përmblyës të vitit 2018. Në këtë ngjarje janë shpalosur zhvillimet në ATK gjatë vitit 2018, objektivat për vitin 2019, si dhe plani i reformave për periudhën 2019-2021.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Sakip Imeri, ka folur rreth performancës së të hyrave për periudhën janar-nëntor 2018, ku tha se përgjatë kësaj periudhe

janë inkasuar 421.8 nga 446 milionë euro sa është projeksioni i përcaktuar për këtë vit. Sipas Imerit, këto shifra tregojnë se është realizuar 94.6 për qind e të hyrave të përgjithshme vjetore, apo 10.7 milionë euro më shumë se plani dhe 39.9 milionë euro më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2017. Kjo performancë e arritur e të hyrave gjatë këtij viti, por edhe aktivitete të tjera të shumta të realizuara, nuk do të ishin të mundura pa mbështetjen e donatorëve dhe palëve të interesit. Ndërsa gjatë takimit pjesëmarrësit, donatorët dhe palët e interesit kanë diskutuar çështje me interes të cilat i përcjellin bizneset në Kosovë. Njëherësh u shprehën të gatshëm për bashkëpunim dhe mbështetje në të gjitha projektet të cilat ATK-ja planifikon t'i zbatojë.

Komuna e Rahovecit organizon panairin treditor me moton "100 % Rahovec"

RAHOVEC, 18 DHJETOR (ER) - Për tri ditë radhazi, 28, 29, 30 dhjetor 2018, me moton "100 % Rahovec" dhe nën dekorimin që vesh qytetin në muajin dhjetor, në hapësirat e qytetit, prej rrugës LAB-OIL deri te Bodrumi i Vjetër, do të mbahet panairi i produkteve vendore, i pari i këtij lloji në Komunën e Rahovecit, që është mbështetur

nga kjo komunë, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm. Qëllimi i këtij panairi është që t'i mbështesë prodhuesit vendorë si dhe ta rrisë vetëdijësimin për konsumim sa më shumë të produkteve vendore. Organizimi i këtij panairi është mjaft i rëndësishëm për faktin se prezantohen vlerat dhe tradi-

tat e prodhimeve vendore, para qytetarëve duke ofruar informacione nga tentat e panairit. Në këtë panair do të plasohen produkte tradicionale si nga qumështi, perimkultura, pije tradicionale (vera e nxehtë), pasi që Rahoveci njihet si rajon bujqësor dhe kultivuese e rrushit si dhe nuk do të mungojë edhe muzika.



KFOR-i gjerman i dhuron Kosovës pajisje në vlerë prej 1.8 milion eurosh



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Pas shndërrimit të kampit të KFOR-it gjerman në Prizren në Park Kosovar-Gjerman Inovativ dhe Trajnues, KFOR-i gjerman nëpërmjet Ministrisë së Financave i ka dhuruar Kosovës pajisje në vlerë prej 1.8 milionë eurosh. Gjatë një vizite në Ministrinë e Financave, përfaqë-

suesit e KFOR-it gjerman në Kosovë kanë theksuar përkushtimin e tyre për mbështetjen e institucioneve të Kosovës përmes projekteve të ngjashme siç është projekti i Parkut Inovativ dhe Trajnues. Për më tepër, ata kanë falënderuar Ministrinë e Financave për përkushtimin në realizimin me

sukses të projekteve me mbështetje të Qeverisë gjermane.

Ndërsa ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se bashkëpunimi me Qeverinë gjermane është dëshmi e një bashkëpunimi me sukses në fusha të ndryshme me partner serioz siç është Qeveria gjermane.

Jetësimi i projektit të Parkut Inovativ dhe Trajnues është një mundësi e jashtëzakonshme për qytetarët e Kosovës dhe institucionet e vendit përmes të cilit pritet të realizohen projekte tejet me rëndësi. Vlen të theksohet se nga ky park në të ardhmen pritet të përfitojnë edhe vendet e rajonit.

Dhurimi i pajisjeve nga KFOR-i gjerman mundëson që Parku Inovativ dhe Trajnues ta fillojë funksionin e tij shumë shpejt. Në fillim të këtij viti, Qeveria e Kosovës dhe Qeveria gjermane patën iniciuar diskutimet mbi të ardhmen e kampit fushor të KFOR-it gjerman në Prizren, pas largimit të trupave ushtarake nga kampi.

Ministria e Bujqësisë mbi 50 milionë euro për bujqësinë në vitin 2019



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe gjatë vitit 2019 në forma të ndryshme do ta vazhdojë mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, por dy instrumentet më të rëndësishme të politikave të ministrisë do të jenë Programi i Zhvillimit Rural dhe Programi i Pagesave Direkte.

Buxheti për këto dy programe zhvillimore për vitin e ardhshëm është planifikuar të jetë 50.7 milionë euro. Kështu është thënë të martën në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ku para anëtarëve të këtij komisioni kanë raportuar zëvendësministri i MBPZHR-së, Mevludin Krasniqi,

sekretari i përgjithshëm i ministrisë, Kapllan Halimi, si dhe u. d. i kryeshefit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), Ekrem Gjokaj.

Zëvendësministri Mevludin Krasniqi ka treguar se buxheti për Ministrinë e Bujqësisë në total për vitin 2019 do të jetë rreth 61.4 milionë euro. Ndërkaq, përmes buxhetit të planifikuar për programet zhvillimore, që arrin mbi 50 milionë euro, ai tha se synojnë rritjen e prodhimit bujqësor, rritjen e aftësisë konkurruese të sektorit agroushqimor si dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në përmirësimin e jetës në zonat rurale.

Dogana ndalon kontrabandën me ari dhe barna

HANI I ELEZIT, 18 DHJETOR (ER) - Ekipet e antikontabandës të martën në orët e hershme të mëngjesit në rajonin e Hanit të Elezit kanë kapur sasi të arit dhe të barnave të cilat po tentoheshin të kontrabandoheshin me autobus. Gjatë kon-

trolleve në pikëkalimin kufitar të Hanit të Elezit oficerët doganorë kanë selektuar për kontroll një autobus të udhëtarëve të linjës Turqi - Kosovë me ç'rast, në një pjesë të autobusit, janë gjetur të fshehura sasi të konsiderueshme të bar-

nave të ndryshme. Pas kësaj është ushtruar kontroll trupor te disa udhëtarë, e që te njëri është gjetur sasi e konsiderueshme e arit. Barnat dhe ari janë konfiskuar derisa ndaj të dyshimtëve është iniciuar procedura kundërvajtëse.



30 fermerë në Skenderaj përfitojnë nga projekti i sektorit të pemëtarisë

SKENDERAJ, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka përgëzuar 30 fermerët përfitues të projektit të sektorit të pemëtarisë, të cilët kanë nënshkruar kontratat për mbështetje me mjete të punës, si: pompë spërkatëse me bateri dhe panel solar, gërhërë për krasitje, sharrë dore dhe pajisje të tjera. "Kemi arritur shifra mbresëlënëse të numrit të

bujqve përfitues të komunës sonë të cilët janë mbështetur nga subvencionet dhe grantet", ka thënë Jashari. Ai ka bërë me dije se viti 2018 po përmbyllet me rreth 250 bujq përfitues nga sektorë të ndryshëm të bujqësisë. "Brenda vetëm një viti punë të qeverisjes sime. Shifrat e këtij viti, të fermerëve përfitues, do të mbesin nën hijen e vitit të ardhshëm!", ka deklaruar kryetari Jashari.



Deçanasit paralajmëron protestë nëse vazhdohet ndërprerja e rrymës

DEÇAN, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se situata me energji elektrike në këtë komunë nuk është e mirë. Ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se ka ftuar në zyrën e tij

përfaqësuesit e KEDS-it, duke i paralajmëruar ata se, nëse nuk ka ndërhyrje emergjente në afat sa më të shpejtë për stabilizimin e energjisë elektrike, atëherë do të ftojë qytetarët në protestë. "Pas situatës së krijuar me gjendjen e rrymës në

Komunën e Deçanit, sot ftova në zyrën time përfaqësuesit e KEDS-it, me këtë rast adresova kërkesën për ndërhyrje emergjente në afat sa më të shpejtë, në të kundërtën do të ftoj qytetarët në protestë", ka shkruar Ramosaj.



Komuna e Prishtinës fillon shpërndarjen e drunjve për familjet që kanë nevojë

PRISHTINË 18 DHJETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka filluar të martën shpërndarjen e drunjve për familjet që kanë nevojë. Kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti, ka treguar se mbi 250 metra dru të grumbulluara nga

pastrimi fito-sanitar i Gërmisë do të shpërndahen për 86 familje me nevojë. "Sot ka filluar shpërndarja e drunjve për familjet në nevojë. Gjatë javëve të kaluara nga pastrimi fito-sanitar i Gërmisë janë grumbulluar mbi

250 metra dru të cilat po i shpërndajmë për 86 familje. Falënderojmë punëtorët e Hortikulturës për punën në këtë ditë me borë", ka shkruar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook".

Në Drenas ndalohet shitja e fishekzjarrëve për personat nën moshën 18-vjeçare

DRENAS, 18 DHJETOR (ER) - Komuna e Drenasit ka njoftuar qytetarët e kësaj komune se ka marrë vendim për subjektet afariste, ku personave nën moshën 18-vjeçare të mos u shiten fishekzjarrët. Po ashtu, kjo komunë ka marrë vendim për ndalimin e ndezjes së fishekzjarrëve në hapësirat publike gjatë festave të fundvitit. "Pasi jemi në prag të festave të fundvitit dhe produktet piroteknike / fishekzjarrët janë në sasi të madhe në treg dhe në duar të konsumatorëve, Drejtoria e Inspeksionit kërkon nga subjektet afariste që zhvillojnë veprimtari të tregtisë, ta

ndalojnë shitjen e produkteve piroteknike/fishekzjarrëve nga personat e paautorizuar dhe të palicencuar për shitjen e tyre si dhe të miturve nën moshën 18-vjeçare. Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka marrë vendim që të ndalohet ndezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit në hapësirat publike dhe zona të banuara, përjashtimisht datës së 31. 12. 2018 nga ora 23:00-00:30, 1. 1. 2019. Personat që veprojnë në kundërshtim me këtë vendim do të gjobiten në shumën prej 100 eurosh", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



Studentëve



Nga Bedri ISLAMI

Po bëhen dy javë që nga protesta juaj dhe kjo është herë e parë që një lëvizje kaq masive gjen edhe miratimin e të gjithëve.

Gjen miratimin e prindërve tuaj? Gjen miratimin e njerëzve të zakonshëm?

Gjen mbështetjen e atyre që u ishte vlarë shpresa se ky vend mund të ndryshojë?

Gjen mbështetjen e bashkëmoshatarëve tuaj në të gjithë botën, ku janë shpërndarë!

Në mënyrën më cinike të mundshme gjen mbështetjen e trupës suaj akademike, të cilët, edhe këto ditë, kur ju jeni në shi apo nën erërat e ftohta, porositin shampanjë për të festuar fundin e vitit në fakultetet tuaja dhe me paratë që ju kanë marrë!

Gjen mbështetjen e qeverisë, e cila i pranon kërkesat, por është mbyllur në kullën qeveritare dhe nuk luan nga istikami!

Gjen mbështetjen e shefit të qeverisë, që, ndërsa ju fton për dialog, përpiqet që përplasjen mes jush dhe shtetit, të kalojë në një përplasje mes jush dhe rektorateve dhe dekanateve.

Gjen mbështetjen e opozitës, e cila është po aq fajtoare, në mos më shumë se sa qeveria për gjendjen e Arsimit në Shqipëri dhe në veçantë të Arsimit të Lartë?

Gjen mbështetjen edhe të atyre që kanë blerë me një dorë para godinat tuaja dhe i kanë kthyer në salla bixhozi, kur vëllezërit e tyre ishin presidentë apo shefa bashkie!

Pra, gjen mbështetjen e të gjithëve!

Kjo ndodh për herë të parë.

Mund të jetë e fundit.

Ju duhet ta dini këtë! Duhet të dini se e drejta juaj, nëse shpërndahet në vijëza politike dhe nëse teprohet me të, ajo mund të shuhet gradualisht ose mund të

bëhet lojë e një populizmi politik, që ju nxjerr në anë të bregut dhe nuk sjell asgjë të mirë për kombin.

Ka gjithnjë një kohë, një moment kur duhet thënë: po më tej?

Po më tej, duhet thënë edhe nga ju.

Të tetë kërkesat tuaja do të gjejnë zbatim. Disa prej tyre menjëherë dhe të tjera do të duan një kohë.

Ajo, më tej, është për Ju. Nuk është as për qeverinë, as për opozitën, as për kuvendin, me ato që janë brenda dhe me ato që mungojnë.

Mos krijoni shansin e humbur duke u përplasur me njerëzit që ju duan!

Mos i bëni të heshtur ato që iu janë gjendur pranë, pa asnjë merak tjetër, veç asaj që e quani kauzë dhe që është e mundur të mbetet e tillë.

Hienat e trupës akademike u janë ngjeshur; pragmatizmi politik, aq larg vizionit tuaj të deritashëm, po ashtu; qeveria luan me kohën dhe me gatishmërinë për të qenë në një tavolinë me ju, e Ju: - Mos e lini të ikë kohën tuaj, të mos përdhoset ajo? ose shtroni vizionin tuaj haptas, ose shkoni në shtëpi, ose kthehuni në auditorë, ose shkoni e bisedoni me forcën që keni sot, e që nesër, politika mund t'ua shterë.

E sotmja mund të jetë pa një nesër!

Fjala e recensuesit

Libër me rëndësi të veçantë historike



Habib MUSTAFA

Libri "Flakadanët e lirisë 5" është libri i 39 i profesorit, shkrimtarit, studiuesit dhe publicistit Bedri Tahiri. Ky autor tashmë është bërë emër i njohur për të gjithë si profesionist i specializuar për libra të tillë, historik-letrar e jetëshkrimor si "Flakadanët e lirisë 5".

Bedri Tahiri deri sot ka botuar (ka edhe shumë dorëshkrime të gatshme që presin dritën e publikimit) disa monografi për dëshmorët e kombit, që nga historia jonë e hershme, duke vazhduar me epokat e mëvonshme e për të kulmuar me ato për dëshmorët e luftës së fundit të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, konkretisht me librin unikat e emblematic "ADEM JASHARI - legjendë e legjendave", i ribotuar dhjetë herë, me mbi 15 mijë kopje.

Në objektivin i interesimit të krijuesit Bedri Tahiri për hartimin e librit më të ri, "Flakadanët e lirisë 5", janë disa nga figurat e shquara të Lëvizjes sonë çlirimtare, që nga Lëvizja Kaçake si: Nak Jashar Berisha, Tahir Shaban Tahiri e Azem Daut Nika, duke vazhduar me figurat e çmuara të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si: Isak Halili, Antigone Fazliu, Ismail Haziri, Nazmi Popova, Januz Jashari, Shahin Sylja, Zymer Haziri, Agim Islami, Blerim Zuçaku dhe Bastri Beqiri.

Që në fillim, pa hezituar, duhet thënë se libri "Flakadanët e lirisë 5" i autorit Bedri Tahiri është i një rëndësie të veçantë për historinë tonë kombëtare. Ai, me një mjeshtri të rrallë artistike e me një rrjedhë të pastër logjike, paraqet vazhdimësinë e pashkëputshmërinë e historisë së popullit shqiptar për çlirim e bashkim kombëtar. Autori, përmes këtij libri dhe librave të tjerë të kësaj serie, më së miri tregon se zjarri i luftës sonë për liri e çlirim kombëtar asnjëherë nuk është shuar. Pra, ai përherë ka qenë flakadan i ndezur lirie, gjë që e dëshmon edhe vetë titulli i veprës.

Për hartimin e këtij libri autori është mbështetur në burime

historike, gojore e të shkruara. Ai, me një aftësi të jashtëzakonshme e me kritere të studiuesit të mirëfilltë dhe me përvojë mbi tridhjetëvjeçare, ka shfrytëzuar për mrekulli: këngët popullore, rrëfimet, rikujtimet dhe mendimet e familjarëve, miqve e bashkëluftëtarëve, si burime të dorës së parë. Krahas tyre, ai ka përdor edhe shumë gazeta dhe revista të kohës, faksimile nga procesverbalet e Aktgjyqimeve dhe literaturën përkatëse ekzistuese.

Libri i Bedri Tahirit "Flakadanët e lirisë 5" është pasuruar edhe me përfshirjen e shumë fotografive dhe dokumenteve autentike, të cilat veçse ia shtojnë edhe më shumë vlerën dhe rëndësinë, duke e shndërruar

në një monument përjetësie për të pavdekshmit. Madje, disa fotografi janë të vjetra dhe shumë interesante, përmes të cilave ne mund të kuptojmë dhe të përfytyrojmë edhe gjendjen ekonomike dhe sociale të kohës. Bedri Tahiri, si studiues i historisë kombëtare, ka dëshirë, dije, vullnet dhe aftësi për të zbuluar, mbrojtur, afirmuar dhe pasqyruar sa më realisht vlerat e atyre që luftuan për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Në fund, autorin Bedri Tahiri, e përgëzojmë për punë kaq të vlefshme, për publikimin e këtij libri lapidar për dëshmorët, duke i uruar jetë të gjatë e shëndet, me shpresë se do të na dhuroj edhe shumë e shumë libra të tjerë të rinj!

ShBA-ja mohon pretendimin e Turqisë për Gylenin

WASHINGTON, 18 DHJETOR - Shtëpia e Bardhë mohoi pretendimin e Turqisë se presidenti Donald Trump po shqyrton mundësinë e ekstradimit të klerikut mysliman Fethullah Gylen që jeton në Shtetet e Bashkuara. Një zyrtar i lartë i Shtëpisë së Bardhë tha se "gjatë takimit me presidentin turk Erdogan në samitin ekonomik të G-20s në Buenos Aires, presidenti Trump nuk bëri ndonjë premtim për ekstradimin e Fethullah Gylenit".



Ministri i Jashtëm turk Mevlut Çavushollu tha më parë në rrjetin televiziv CNBC se Trumpi i kishte komunikuar presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan se ShBA-të janë duke punuar për ekstradimin e Gylenit dhe "njerëzve të tjerë". Gyleni jeton në mërgim në Pensilvani. Turqia e akuzon atë për orkestrimin e grushtit ushtarak të shtetit kundër presidentit Erdogan në vitin 2016. Gyleni e mohon akuzën, por Ankaraja ka kërkuar që Shtetet e

Bashkuara ta ekstradojnë atë në Turqi. Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Turqia nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme që mbështesin pretendimin e saj kundër Gylenit. Çavushollu tha se ai ka parë një hetim "të besueshëm" të FBI-së që tregon se si organizata Gylen i shmanget pagimit të taksave. Erdogani tha javën e kaluar se qeveria e tij do të fillojë të verë në shënjestër ata që financojnë operacionet e Gylenit.

Raportet e Senatit dokumentojnë ndikimin rus në zgjedhjet presidenciale të ShBA-së

Komuniteti i Inteligjencës amerikane ka vërtetuar në janar të vitit 2017 se Moska ka favorizuar Trumpin për dallim nga rivalja e tij demokrate, Hillary Clinton dhe, nëpërmjet hakimit të kompjuterëve dhe propagandës në rrjetet sociale, ka ndikuar në ndjenjat e votuesve



WASHINGTON, 18 DHJETOR - Dy raporte të përgatitura për Senatën amerikanë kanë dokumentuar ndikimin që ka pasur fushata e drejtuar nga rusët për ta ndryshuar opinionin e votuesve amerikanë gjatë fushatës për zgjedhjet presidenciale më 2016. Raportet, të publikuara më 17 dhjetor, janë përgatitur për Komitetin e Senatit për Inteligjencë, njëherësh njërin nga panelet kongresionale që heton si Rusia ka synuar të ndikojë në zgjedhjet që i ka fituar presidenti aktual Donald Trump. Pas hetimit të miliona postimeve në "Twitter", "Facebook", videove në "YouTube", fotografive në "Instagram" dhe pjesës tjetër të përmbajtjes në rrjetet sociale, raportet janë të një rëndësie të veçantë për të kuptuar se si rusët kanë keqpërdorur teknologjinë për ta shpërndarë dezinformimin.

Komuniteti i Inteligjencës amerikane ka vërtetuar në janar të vitit 2017 se Moska ka favorizuar Trumpin për dallim nga rivalja e tij demokrate, Hillary Clinton dhe, nëpërmjet hakimit të kompjuterëve dhe propagandës në rrjetet sociale, ka ndikuar në ndjenjat e votuesve. Në njërin nga raportet janë pasqyruar detaje të reja rreth asaj se si rusët që kanë

punuar në kompaninë me seli në Shën Petersburg, Agjencia për Kërkime në Internet, kanë krijuar profile të reze dhe kanë përdorur rrjetet sociale si "Facebook", "Twitter" dhe "Google" për të shpërndarë dezinformata me qëllim të mbështetjes së Trumpit dhe denigrimit të Clintonit. E njohur zakonisht si "qendër e çorientimit", Agjencia për Kërkime në Internet është raportuar të jetë financuar nga biznesmeni i lidhur me Kremlinin, Yevgeny Prigozhin. Ai dhe 12 persona të tjerë janë paditur nga Këshilltari Special, Robert Mueller, në muajin shkurt me akuza për mashtrime bankare, komplot dhe vjedhje të identitetit. "Është e qartë se të gjitha mesazhet kanë pasur qëllim që të jenë përfituese për Partinë Republikane, sidomos për Donald Trumpin", është thënë në raportin, detajet e të cilit janë publikuar për herë të parë nga gazeta, "The Washington Post".

Ky raport është përpiluar nga Projekti i Propagandës Kompjuterike i Universitetit të Oksfordit dhe kompania për analizimin e medieve sociale, "Graphika". Në shumicën e postimeve në rrjetet sociale, raportet janë fokusuar në atë se si përmbajtja e sponsorizuar nga Rusia

ka pasur synim të ndikojë në pikëpamjet e konservatorëve në çështjet si imigrimi dhe të drejtat për armët.

Raporti i tyre ndërkaq është përgatitur nga hulumtuesit për Njohuri të Re në kuadër të Universitetit të Kolumbisë dhe është fokusuar në operacionet ruse që kanë shënjestruar njerëzit me ngjyrë dhe disa komunitete tjera që përkrahin demokratët. Përveç të tjerash raporti, ka analizuar edhe si këto operacione kanë tentuar të përçajnë sistemin elektoral amerikan, si dhe kanë shpërndarë dezinformata për çështjet rreth asaj se sa herë mund të kenë votuar disa persona.

Në raport është thënë se

Agjencia për Kërkime në Internet "ka krijuar platforma mediale me synim të ndikimit në komunitetin e njerëzve me ngjyrë, ashtu që të krijojë një ekosistem me qëllim të ndikimit".

Në të dyja raportet është theksuar se si Agjencia për Kërkime në Internet nuk ka shpërndarë mesazhet vetëm në "Instagram", "Facebook" dhe "Twitter", mirëpo edhe në platformat të tjera si "Tumblr", "Pinterest", "YouTube", "Reddit", "Vine" dhe "Google+". "Përgjatë përpjekjeve të njëpasnjëshme, Agjencia për Kërkime në Internet ka shfrytëzuar ndarjet në shoqërinë tonë dhe dobësitë në sistemin tonë të informacionit", është thënë në raport.

Ata kanë shfrytëzuar edhe pakënaqësitë që kanë ekzistuar në shoqëri dhe paragjykimet e ndryshme në mënyrë që të ndikojnë në perceptimet amerikane, është thënë në raportin e ashtuquajtur Njohuria e Re.

Në këto raporte janë analizuar të dhëna dhe përmbajtje nga viti 2016 deri në mes të vitit 2017. Në të dhëna nuk përfshihen zgjedhjet e mbajtura për Kongres më 2018.

Ndërkohë një raport i kërkuar nga Shtëpia e Bardhë, nëse votimet për Kongres të këtij viti janë ndikuar nga aktorë të jashtëm, pritet të publikohet nga agjenci të inteligjencës dhe ato për zbatim të ligjit më 21 dhjetor.

Qeveria britanike po përgatitet për një Brexit pa marrëveshje

Londër, 18 dhjetor - Kabineti i kryeministres britanike, Theresa May, po merr në konsideratë përsheptimin e përgatitjeve për daljen e vendit nga Bashkimi Evropian pa një mar-

rëveshje. Pritet që kabineti qeveritar të ndajë fonde në vlerë prej 2.2 miliardë eurosh për të zbutur një kaos të mundshëm ekonomik. Ministri për Komunitetin dhe

Pushtetin Lokal, James Brokenshtein, i tha BBC-së se qeveria ka kohë që e kupton mundësinë e daljes nga BE-ja pa një marrëveshje, por që tani është përgatitur për një Brexit

kaotik. Rreth 100 ditë përpara se Britania të largohet nga BE-ja, mbetet e paqartë nëse kjo do të bëhet me ose pa marrëveshje, e cila mund të kishte pasoja në ekonominë e vendit.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E rrallë

Arrestohet personi që hodhi paratë nga pallati

Kalimtarët u shtynë t'i mblidhnin kartëmonedhat që po fluturonin nga një ndërtesë. Ngjarja ndodhi në një lagje punëtorësh në Hong Kong dhe personi që i hodhi paratë u arrestua nga policia për prishje të rendit. Ai quhet Uong Çing-kit, është 24 vjeç dhe njihet si "Mjeshtër Monedhash Virtuale", pasi ka një kompani që reklamonte monedhat digjitale si "Bitcoin".



FOTO E DITES



Pamje dimri nga bjeshkët e Rugovës në Pejë. /Foto: Granit Dinaj/

E jashtëzakonshme

Në një burg në Korenë Jugore njerëzit hyjnë vullnetarisht

Prej vitit 2013 'Burgu Brenda Meje' është vizituar nga më se 2 000 veta që duan të ikin nga rutina e ngjeshur në Korenë Jugore. Disa koreanë

po e shfrytëzojnë këtë burg të improvizuar që të qëndrojnë në qetësi të plotë, që konsiderohet se ua sjellë "lirinë e brendshme". Në 28 dhomat e



qendrës që kanë nga pesë metra katrorë, ata qëndrojnë në qetësi të plotë, por e kanë edhe butonin e panikut po që se nuk mund të durojnë më.

BARSOLETA E DITËS



- E kam blerë një kuletë në formë të armës.
- Pse?
- Se po shpresoj mos po e mbush dreqi.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot do të ndiheni mjaft krenar për një gjest tuajin dhe nuk do të bëni modestët tek ata persona që do t'ju përgëzojnë pa asnjë rezervë.</p>	 <p>DEMI Do të ngriheni me humor të keq sot dhe që në orët e para të ditës ata që kanë punë me ju do ta kuptojnë që diçka nuk shkon.</p>	 <p>BINJAKËT Keni dëshirë të merrni pjesë në shumë aktivitete dhe iniciativa sot, por edhe një ditë e plotë nuk ju mjafton. Duhet të filloni të përzgjidhni.</p>	 <p>GAFORRJA Sot jeni mjaft ambicioz dhe do të tregoni që dini të luftoni për atë çka mendoni të drejtë si dhe të merrni atë që ju takon me meritë.</p>	 <p>LUANI Jeni shumë protektivë karshi personave të dashur sot. Mbase duhet të kuptoni që gabimet në jetë mësojnë shumë më tepër se teoritë.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Sot nuk do të toleroni më neglizhenca të tjera lidhur me një projekt tuajin. Jeni munduar t'i mirëkuptoni të tjerët deri më sot, por e kanë marrë si dobësi.</p>
 <p>PESHORJA Sot me durim do të arrini të shmangni ato situata të pakëndshme që mund t'ju shënojnë ditën. Ndjeni një frymë pesimizmi në ambientin e punës.</p>	 <p>AKREPI Edhe pse ju duket se i keni financat e sigurta për ca kohë nuk duhet të qëndroni në vendnumëro. Keni mundësi të ecni përpara në karrierë.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot keni humbur në mendime dhe nuk shihni se çfarë bëhet rreth jush. Dikush mund të përfitojë nga mosvëmendja juaj.</p>	 <p>BRICJAPI Pak pushim nga rutina do t'ju ndihmojë të nisni përsëri me këmbën e mbarë. Do të arratiseni në një vend që ju pëlqen shumë.</p>	 <p>UJORI Dihet që sa më lart kërkon të ngjitesh aq më të mëdha bëhen pengesat. Kjo vlen edhe për rastin tuaj, por nuk do t'ju trembë për të guxuar më shumë.</p>	 <p>PESHQIT Sot edhe një herë do të jeni ju që do të nxirrni nga situata një person të afërt. Megjithatë të papërgatitur, do të arrini t'ia dilni në një situatë të caktuar.</p>

Justin Bieber vazhdon t'i telefonojë Selena Gomezit



Justin Bieber ka filluar një kapitull të ri romantik me bashkëshorten e tij Hailey Baldwin, por ende në zemrën e Justinin ka një hapësirë për Selena Gomezin. Raportohet se këngëtari po përpiket t'i afrohet ish të dashurës së tij. Megjithatë, qëllimet e tij nuk rrjedhin nga ndjenja romantike por, thjesht, nga shqetësimi për gjendjen e

këngëtares. Selena u shtrua në një qendër rehabilitimi dhe doli vetëm pak kohë më parë, gjë që shqetësoi Justinin. Ai u ndie i detyruar që t'i qëndronte pranë për ta kontrolluar gjendjen e saj mendore, pavarësisht se është i pandashëm nga bashkëshortja e tij Hailey. "Justin Bieber vazhdon ta kontaktojë Selenën në telefon", ka thënë një burim.

Martohet Grant Gustin



Grant Gustin është tashmë një burrë i martuar. Aktori 28-vjeçar dhe e fejuara e tij LA Thoma i kanë thënë po njëri-tjetrit javën që lamë pas në Los Angeles. "E! News"

raporton se lista e të ftuarve përfshinte fytyra publike si Melissa Benoist dhe Chris Wood, RJ Brown, Ben Ross dhe të tjerë. Grant dhe LA njoftuan fejesën në prill të vitit të kaluar.



Sophie Turner dhe Joe Jonas, 'kokë e këmbë' të dashuruar

A ta janë kokë e këmbë të dashuruar. Sophie Turner dhe i fejuari i saj Joe Jonas janë parë duke u puthur në qytetin e Nju Jorkut para se aktorja 22-vjeçare të futej në aeroplan për të udhëtuar për në Los Angeles. Ylli i Game of

Thrones, e cila ishte pa grim, kishte të veshur një pallto gëzofi dhe atlete të markës së njohur Louis Vuitton derisa 29-vjeçari Joas kishte veshur një xhakëtë të markës Moncler me vlerë hiç më pak se 1 785 dollarë.

Offset flet për herë të parë pasi i kërkoi falje Cardi B-së

Gjatë fundjavës Offset hyri në skenën ku po performonte Cardi B, duke u përpjekur ta rikthente atë pas tradhtisë. Ngjarja e dokumentuar me video në rrjete sociale u bë virale. Reperi ka komentuar në "Twitter" ngjarjen për herë të parë duke shkruar: "Të gjitha gabimet e mia janë bërë publike dhe figurojnë kudo. Është e drejtë që edhe kërkimfaljet e mia të bëhen publike. Isha duke u përpjekur". Ka qenë Cardi B ajo e cila



fillimisht hyri në "Instagram" për të postuar një video me anë të së cilës njoftoi se ishte ndarë nga babai i vajzës së saj.

Pesë arsye të mira për të pasur një mik mashkull

Ndonjëherë miqësia mashkullore mund të rezervojë surpriza të këndshme: këtu janë disa arsye të mira për të mos lënë pas dore shokët e aventurave

Një burrë si miku më i mirë: për shumë duket e pamundur, por është një marrëdhënie që mund të funksionojë, përkundrazi ndoshta është ndër më të fortat që mund të imagjinohet. Po, sepse nëse është e vërtetë që shumë anëtarë të seksit tjetër nuk mund të mos jenë tërësisht të interesuar për të na frekuentuar, është gjithashtu e vërtetë që burrat nuk kanë zili ose rivalitet ndaj nesh, gjë që është shumë e zakonshme te gratë. Këtu, pra, janë disa arsye të vlefshme për të mos lënë pas dore një miqësi të bukur, e cila mund të jetë një burim pasurimi personal, krahasim i sinqertë dhe madje mund të na çojë në diçka tjetër, pse jo? OK, le ta pranojmë: te meshkujt na pëlqen konkretësia, simpatia dhe sinqeriteti.

Lamtumirë zilisë dhe rivalitetit, nuk na ngelet gjë tjetër veçse të kemi një mik, me të cilin mund të flasim për gjithçka, pa frikën e të qenit e gjykuar dhe që mund

të na ofrojë një pikëpamje ndryshe dhe më pak të rëndësishme emocionale sesa do të kishim nga miqësitë e femrave. Për më tepër, dy krahë të fortë mund të jenë një ndihmë e vlefshme në rast vështirësie: këtu janë pesë arsye të vlefshme për të mos hequr dorë nga një miqësi mashkullore.

Më prezanto një mik: Ata që janë single e dinë mirë: të pyesësh mikeshat nëse kanë një mik të disponueshëm dhe pa lidhje është shumë e shpeshtë, por shpesh mikeshat tona ose nuk njohin askënd për të na prezantuar, ose – në qoftë se kanë, – e mbajnë në mënyrë rigorozë për veten e tyre. Sidoqoftë, para se të lëmë një takim, mikeshat janë gjithnjë shumë të kujdesshme, na fusin një mijë dyshime dhe shpesh entuziazmi i një të njohuri të ri është më i paktë para se të takohemi. Ndërkohë, meshkujt janë pa dyshim më të drejtpërdrejtë

dhe praktikë, dinë si të prezantohen dhe nuk vazhdojnë më nëse takimi nuk ka efektet e dëshiruara. Të qenit i prekshëm shpesh është një privilegj femëror, burrat janë më të drejtpërdrejtë: me siguri ata do të jenë në gjendje të qeshin ose të gëzohen sinqerisht nëse gjithçka shkon mirë. Bujari para së gjithash.

Rroftë sinqeriteti: T'i kërkoni mendim një gruajë mund të jetë një shpatë me dy tehe: nga njëra anë, një mikeshë sigurisht na kupton për veshjen, make-up, formën fizike, nga ana tjetër nuk është e thënë që ta shprehin me sinqeritet mendimin e tyre: zilia është gjithmonë rreth e rrotull dhe shpesh bëhet një pengesë pothuajse e pakapërcyeshme. Ndërkohë, opinioni i meshkujve është më i sinqertë, pa qëllime të këqija dhe nëse thonë se kjo veshje na rri mirë, kjo do të thotë se me të vërtetë jemi shumë tërheqëse, por nëse këpucët, – megjithëse në modë, – ju duken atyre horror, kjo me siguri do të thotë se në qoftë se ne menduam se ishim joshëse, për fat të keq kemi efekt të kundërt. Nëse meshkujt nuk kuptojnë nga truket ose moda

është një anë dhe që ata mund të na japin një mendim të paanshëm dhe të dobishëm është një anë tjetër. Le të meditojmë, njerëz...

Në rast emergjence: A ju ka ndodhur ndonjëherë t'ju shpohet goma e makinës? Le të ngrenë dorën ata që kanë menduar një mikeshë për të gjetur zgjidhjen: le ta pranojmë, askush! Kur jemi në telashe serioze me makinën, miku ynë mashkull do të dijë të jetë ndihmë dhe përkrahje e jashtëzakonshme, pa na bërë të ndihemi të padobishëm dhe naivë, përkundrazi do të jetë i lumtur që mund të na ndihmojë. E njëjta gjë nëse kemi probleme me TV apo nëse duhet të mbajmë pako të rënda: të dimë se mund të mbështetemi te një krah i fortë është një garanci për mbi-jetesë!

Më mirë të shoqëruara: Ka situata ku nuk mund të prezantohemi vetëm, duhet patjetër të jemi të shoqëruara. Atëherë, shoku ynë më i mirë mund të jetë një partner i shkëlqyer për të na shoqëruar, si dhe për të na mbajtur kur jemi në taka dymbëdhjetë centimetërshe: miqësia

është e përsosur sepse na jep atë intimitet që lehtësisht mund të merret për diçka tjetër, por në të njëjtën kohë është i privuar nga ai pasion që i bën sytë të ndriçojnë dhe që do të ngjallte një kuriozitet të fshehur keq.

Një ngushëllim i këndshëm: OK, nuk duam bashkëshortë, as nuk jemi duke kërkuar marrëdhënie shumë të angazhuara. Shkurtime, ne jemi ende të pavendosura, por në të njëjtën kohë kemi nevojë për dashuri dhe butësi. Epo, miku ynë më i mirë është atje për të na përqaftuar dhe për të na qëndruar pranë. Fillimi i një historie dashurie nuk është keq, veçanërisht sepse nuk është dashuri me shikim të parë, por një ndjenjë që rritet ngadalë-ngadalë me kohën. Ne dimë gjithçka për të, ashtu siç ai di gjithçka për ne: ne mund të ndihemi vetvetja, të lira nga çdo kondicionim dhe paragjykim. Seksi nuk mund të jetë aspak keq dhe nga aty hapi për të rënë në dashuri me të mund të jetë i shkurtër. Ndonjëherë, Cupid është i djallëzuar dhe i paparashikueshëm, kurrë mos e harroni atë!

(gazeta-Shqip.com)



Pushime në Nju Jork, për një Vit të Ri të paharrueshëm (Foto)

Nga Manhattan në Bronx, eventet shpërthyes për ta pritur vitin e ri në metropolin mitik

Doni ta festoni sa më mirë ardhjen e Vitit të Ri? E ku ka më mirë se Nju Jorku. Nëse zemra e festimeve do të jetë edhe këtë vit Times Square me shfaqje sensationale, dritat dhe numërimin e ikonave të skanuara nga Ball Drop, vizitorët në qytet do të gjejnë në të gjitha rrethet argëtuese të siguruar. Këtu është një përzierje dhe ngjarjeve më interesante.

Times Square – Festimet në Times Square për vitin e ri do të fillojnë më 13 dhjetor kur dy numrat 1 dhe 9 në formatin gjigant do të shfaqen në sheshin më të famshëm në botë, deri më 22 dhjetor. Shkrepe perfekte për t'i ndarë në "Instagram". Më 28 dhjetor, nga ora 12.00 deri në orën 13.00 në Broadëay Plaza në Times Square, do të mbahet Dita e

Ball Drop – Tradita e vërtetë e Vitit të Ri në NYC është Ball Drop, zbritja e sferës së ndritshme nga rrokaqiell i One Times Square deri në mesnatë të vitit të ri. Duke u bërë një simbol ikonë në të gjithë botën, sfera peshon rreth 6 ton dhe është e mbuluar nga 2,688 kristale Èaterford, të cilat ndriçojnë natën me mbi 16 milionë ngjyra kaleidoskopike. Lokalet në afërsi do t'u ofrojnë të ftuarve të tyre një doll me pamje për të festuar ardhjen e vitit të ri.

Manhattan – Prej 21 deri 1 të mëngjesit më 1 janar, vizitorët mund të shijojnë një dalje në det në bordin e 'Circle Line' për të admiruar pamjen e mrekullueshme të horizontit dhe shfaqjen mbresëlënëse të fishekzjarreve



çlirimit në bashkëpunim me kompaninë Shred-in, për të shkatërruar kujtimet e këqija të vitit 2018 dhe për të filluar më mirë vitin e ri.

Muri i Dëshirave – Nga 1 deri më 29 dhjetor, ëndrrat dhe qëllimet e mira për vitin 2019 mund të mbështeten në Murin e Dëshirave në sheshin Times Square, mbledhur në fletë e letër me ngjyrë. Në prag të Vitit të Ri, në mesnatë, të gjitha dëshirat do të lansohen si konfeti në turmë si një shenjë e mirë për vitin e ri. Ata që nuk do të jenë në gjendje të vizitojnë Murin e Dëshirave personalisht, do të jenë në gjendje të ndajnë dëshirat e tyre në format elektronike, nëpërmjet faqes së internetit, në Tëitter dhe Instagram me hashtag #ConfettiEish.



jë fundin e vitit 2018 me një ndriçim të gjallë LED që do të qëndrojë deri më 31 dhjetor. Pesë minuta para mesnatës ndërtesa do të bëhet e bardhë deri në agim deri më 1 janar 2019.

Koncerte në Manhattan – Nga 28 deri më 31 dhjetor, grupi rock Phish do të kthehet në Madison Square Garden për performancën e 60-të. Publiku do të jetë në gjendje të presë vitin e ri, duke kënduar dhe vallëzuar hitet e viteve '90. Katër herë fituesi i Grammy, Renee Fleming, do të performojë së bashku me filarmoninë dhe dirig-

jentin e ri Jaap van Zweden për koncertin vjetor të Filarmonisë së Vitit të Ri.

Brooklyn – Festimi i fishekzjarreve të Vitit të Ri do të zhvillohet në lagjen e famshme, në pallatin historik të Ushtrisë së Madhe në Prospect Park, Brooklyn. Ngjarja është falas me argëtim të gjallë dhe fishekzjarre të jashtëzakonshme. Gjithashtu në Coney Island, sipas traditës, notimi i parë në Oqeanin e organizuar nga Polar Bear Club do të zhvillohet më 1 janar. Regjistrimi është i lirë dhe takimi është caktuar në orën 13:00 në ujërat e Stillell

Avenue. Në fund të notit, ju mund të hyni në Neë York Aquarium dhe të ngrohni në Coney Island Breëing Company.

Bronx – Ekspozita e Festave të Trenit në Kopshtin Botëror të Nju Jorkut do të mbetet e hapur deri në orën 18:00 më 1 janar. Kjo ekspozitë vjetore pret shumë modele trenash që lëvizin në një miniaturë të qytetit të Nju Jorkut me mbi 175 rindërtime të ndërtesave, duke përfshirë risitë si Oculus, One Eord Trade Center dhe Battery Detention Building.

(gazeta-Shqip.com)





Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

HIBERNIAN - RANGERS

2

WERDER BREMEN - HOFFENHEIM

1

MAINZ - EINTRACHT FRANKFURT

GG

Beqiri: Mbijetesa nuk diskutohet, synojmë Kupën

Arben Beqiri ka qenë një nga lojtarët më të mirë për skuadrën e Trepçës '89 në sezonin vjeshtor. Ai ka kontratë me këtë klub edhe një vit e gjysmë, kurse lidhur me synimet për këtë edicion ka thënë se synohet Kupa e Kosovës. Lidhur me garën për mbijetesë, portieri nuk beson se do të diskutohet. "Nuk besoj se Trepça '89 do të ketë telashe për mbijetesë duke pasur parasysh seriozitetin e klubit dhe organizimin që e ka nder vite", ka thënë Beqiri

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Portieri i skuadrës së Trepçës '89, Arben Beqiri, është shprehur i pakënaqur me rezultatet e arritura nga skuadra e '89-shit në sezonin vjeshtor. Ai ka thënë të martën për "Epokën e re" se janë pritur rezultate më të mira, por ndryshimet e shumta kanë ndikuar që kjo skuadër mos të ketë stabilitet në rezultate. "Kampionatin nuk e kemi nisur mirë, por dihet se këtë vit në klub ka pasur shumë ndryshime brenda ekipit, shumë largime dhe përforcime. Duke pasur parasysh përforcimet që janë bërë, synimi ynë ka qenë kreu i tabelës, por ja që tash jemi në pozitë jo të mirë dhe shpresojmë se në pranverë do të përmirësohemi edhe më

shumë dhe do të jemi aty ku Trepça '89 e meriton, në mesin e skuadrave të para në tabelë", ka thënë Beqiri. Portieri i skuadrës nga "Riza Lushta" është i bindur se mbijetesa nuk do të diskutohet, ani pse skuadra e Trepçës '89 renditet në pjesën e poshtme në tabelë. "Nuk besoj se Trepça '89 do të ketë telashe për mbijetesë, duke pasur parasysh seriozitetin e klubit dhe organizimin që e ka nder vite. Sa iu përket përforcimeve, mendoj se kemi nevojë për katër apo pesë futbollistë", ka deklaruar ai.

Një sukses që mund ta shpëtonte kampionatin e '89-shit është gara e Kupës ku në çerekfinale do të përballlet me Prishtinën. Beqiri, që është ndër shtyllat kryesore në skuadrën mitrovicase, ka thënë se synimi i tyre është triumfi në këtë garë edhe

përkundër faktit se fillimisht përballë e kanë një skuadër shumë të fortë. "Në garën e Kupës jemi në çerekfinale. Do të përballemi me Prishtinën. Do t'i bëjmë përgatitjet për këtë ndeshje pasi kemi kohë të mjaftueshme dhe sigurisht se do të jetë një ndeshje shumë e rëndësishme për neve pasi objektivi ynë do të jetë Kupa për shkak që në kampionat kemi ngecur prapa në garën për titull", ka përfunduar ai.

Trepça '89 e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e tetë me 22 pikë të grumbulluara, ku nga shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara regjistroi pesë fitore, shtatë barazime dhe pesë humbje. Kjo skuadër është një pikë larg zonës së rrezikshme dhe tetëmbëdhjetë pikë pas skuadrës lidere në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

SHKURT

Vëllaznimit transferon Jetullahun dhe Beqirin

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova vazhdon të jetë aktive për transferimin e futbollistëve. Mesfushori Labinot Jetullahu, i cili ishte pjesë e KF Drita, KF Trepça '89 dhe, së fundmi, pjesë e KF Onix, ka nënshkruar për skuadrën kuqezi nga Gjakova. Jetullahu ka nënshkruar kontratë deri në qershor të vitit 2020. Vëllaznimit është përforcuar me qendërmbrojtësin Agron Beqiri, i cili sezonin vjeshtor ishte pjesë e KF Onix. Futbollisti në fjalë ka nënshkruar me skuadrën gjakovare kontratë deri në fund të edicionit 2019/20.

Talenti shqiptar shpallet lojtari i muajit në Slloveni

Fraçesko Tahiraj është shpallur lojtari i muajit në kampionatin slloven të futbollit. Sulmuesi i krahut po kalon një moment mjaft të mirë me ekipin Aluminij, teksa në katër ndeshje ka shënuar pesë gola. Me origjinë nga Vlora, Tahiraj shpreson që ecuria e mirë të ketë rënë edhe në sytë e trajnerit Christian Panucci, për një ftesë në grumbullimet e ardhshme. 22-vjeçari prej tre sezonesh aktivizohet tek Aluminij në Slloveni dhe tashmë pret ta bëjë edhe hapin e madh në karrierë.

Zeneli: Luftojmë për Vokrrin dhe popullin tonë

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, ka dhënë një intervistë interesante për faqen zyrtare të FIFA-s. Ai foli për vitin e jashtëzakonshëm të Kosovës, ku "Dardanët" e bënë të lumtur gjithë popullin shqiptar. "Ka qenë një vit fantastik për ne si shtet i ri. Nuk e kemi menduar kurrë që do të jemi të pamposhtur për një vit. Pas një kohe që zgjedha Kosovën, e ndjeva se mora vendimin e duhur. Dëgjova zemrën time dhe mora atë vendim. Deri më tani s'jam pënduar për asnjë moment. Prindërit e mi kanë qenë refugjatë. Pas pranimit në FIFA ishim shumë të lumtur, por edhe të dëshpëruar sepse kishim luftuar shumë", ka thënë Zeneli.

Ai e vlerësoi të paharrueshme ndeshjen e parë zyrtare, kualifikimet e Botërorit dhe fitoren e parë. "Fitorja e parë ishte diçka fantastike, edhe sepse presidenti i Federatës ndërroi jetë pak më herët. Ai na mundësoi këtë rrugë dhe ne do t'i jemi gjithmonë falënderues atij. Ndaj Azerbajxhanit ishte një mbrëmje e madhe. Atyre u duhej fitorja, por ne bëmë punë të madhe. Jemi në 'play-off' të Ligës së Kombeve, por do të luftojmë edhe në kualifikime që ta sigurojmë biletën nëse mundemi. Viti i ardhshëm do të jetë shumë interesant", ka deklaruar Zeneli.

Prishtina për fitore ndaj Szolnoki Olajt

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Z Mobile Prishtina të mërkurën është nikoqire e ekipit Szolnoki Olaj nga Hungaria në kuadër të raundit të dytë të FIBA Europe Cup.

Ndeshja do të zhvillohet me fillim nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Në ndeshjen e parë në kuadër të raundit të dytë të FIBA Europe

Cup të luajtur në Gjermani, Z Mobile Prishtina ka pësuar disfatë me shifrat 95:77 nga ekipi Oliver Wurzburg. Megjithatë, në përballjen me hungarezët, bas-

ketbollistët kryeqytetas të Kosovës edhe me përkrahjen e tifozëve vendës pritet të bëjnë më të mirën për të nxjerrë rezultat pozitiv.



Messi për herë të pesë e fiton "Këpucën e Artë"

BARCELONË, 18 DHJETOR - Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, e ka marrë çmimin e pestë rekord "Këpuca e Artë" si golashënuesi më i mirë në të gjitha ligat evropiane sezonin e kaluar. Superylli argjentinas tani e kalon Cristiano

Ronaldon, që i ka katër, në listën e futbollistëve me më së shumti çmime të "Këpucës së Artë". Messi i shënoi 34 gola në ligën elitare spanjolle, La Liga, sezonin e kaluar duke i ndihmuar Barcelonës ta fitojë titullin, po ashtu.

Sulmuesi i Liverpoolit, Mohamed Salah, ishte i dyti me 32 golat e tij në Premierligë. Messi e ka fituar këtë trofe në sezonet 2009-10 (34 gola), 2011-12 (50 gola), 2012-13 (46 gola), 2016-17 (37) dhe tani 2017-18 (34

gola). 31-vjeçari është golashënuesi më i mirë në histori të Barçës, me 572 gola në 655 ndeshje. "Këpuca e Artë" ndahet nga "European Sports Media", një shoqatë e gaze-



tave dhe revistave evropiane të sportit.

Shkarkohet Mourinho, Zidane favorit kryesor për ta zëvendësuar

MANCHESTER, 18 DHJETOR - Manchester Unitedi e ka shkarkuar trajnerin Jose Mourinho pas humbjes që pësoi të dielën ndaj Liverpoolit (3-1). Në këtë ndeshje dy golat e fitores për "Redsat" i kishte shënuar futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri. Rezultat e dobëta në këtë edicion nga skuadra e Manchester Unitedit dhe renditja momentale në tabelë me 19 pikë pas Liverpoolit që është lider, ka ndikuar që tifozët dhe drejtuesit e klubit ta humbasin durimin. "E falënderojmë Josen për punën e tij të deritanishme me Manchester Unitedin dhe i urojmë sukses në të ardhmen. Për momentin një trajner i përkohshëm do ta marrë drejtimin e skuadrës deri në fund të këtij sezoni, ndërsa klubi do ta përfundojë procesin e rekrutimit për një trajner të ri me kohë të plotë", thuhet në njoftimin e Manchester Unitedi. Mourinho ditë më parë bëri të qartë se pozita e katërt është synim i Unitedit, kurse raportet më zëvendësuesit të tij kanë qenë jashtëzakonisht të këqija. Ish-trajneri i Portos,



Chelsea, Real Madridit dhe Interit mori drejtimin e Manchester Unitedit në vitin 2016. Mediet në ishull menjëherë kanë filluar të raportojnë për zëvendësuesin e mundshëm të trajnerit portugez, i cili kishte nënshkruar me

Manchester Unitedin më 27 maj të vitit 2016. Favoriti kryesor është trajneri Zinedine Zidane, kurse pas tij përmenden edhe emrat e Antonio Contes, Mauricio Pochetinos, Lorent Blancut dhe Arsen Wengerit.

Curry mes rekordmeneve, Golden State mposhti Memphisin

Oakland, 18 dhjetor - Stephen Curry është një "yll" në NBA dhe në takimin e fundit që Golden State Warriors fitoi me Memphis Grizzliesin me rezultatin 110-93. Ai arriti ta kapte shifrën e 15 000 pikëve të shënuara. Curry bëhet basketbollisti i pestë i Warriorsit që e arrin një shifër të tillë. Wilt Chamberlain (17783), Rick Barry (16447), Paul Arizin (16266) dhe Chris Mullin (16235) janë para liderit të kampionëve në fuqi. Në këtë takim ai realizoi 20 pikë, ndërkohe që më mirë bëri Kevin Duranti me tre pikë më shumë. E rëndësishme ishte fitorja, e 21-ta sezonale për Warriorsin. Giannis Antetokounmpo (32 pikë, 5 asistime, 12 topa të rikuperuar) udhëhoqi Milwaukee Bucks në fitoren 104-107 të arritur ndaj Detroit Pistonsit. Blake Griffin me shokë doli i mposhtur, edhe pse realizoi 'triple-



double': 19 pikë, 11 asistime, 10 topa të rikuperuar. James Hardeni është i pandalshëm sërish, teksa ka realizuar 47 pikë në fitoren 102-97 që Houston Rocketsi mori kundër Utah Jazzit. Fitore tjetër e Phoenix Suns, me Devin Bookerin që shënoi 38 pikë kundër New York Knicksit.

REZULTATET

Detroit Pistons - Milwaukee Bucks	104-107
New York - Phoenix Suns	110-128
Minnesota - Sacramento	132-105
Houston - Utah Jazz	102-97
Oklahoma City - Chicago Bulls	121-96
San Antonio - Philadelphia	123-96
LA Clippers - Portland	127-131
Golden State - Memphis	110-93

SHKURT

Aliti transferohet në Suedi

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës, Fidan Aliti, pritet të transferohet në kampionatin elitare të Suedisë, me Malmo dhe Norrkoepingun që tashmë kanë shfaqur interesim për të. Mediet në Shqipëri raportuan se Skënderbeu ka arritur marrëveshje me një skuadër suedeze, duke mos e bërë me dije emrin e klubit. Nga shitja e Alitit, siç shkruan "Telesport", Skënderbeu pritet të përfitojë 500 mijë euro. Për Alitin interesim kanë shprehur skuadra kampione e Suedisë AIK-u, Malmo dhe Norrkoepingu. Aliti 25-vjeçar me Skënderbeun ka kontratë deri në qershor të vitit të ardhshëm.

Mendes: Ronaldo kishte kërkuar transferimin te Juve gjatë janarit


Agjenti i Cristiano Ronaldos, Jorge Mendes, ka zbuluar se portugezi kishte kërkuar t'i bashkohej Juventusit që në afatin kalimtar të janarit. Por, pasi negociatat kishin vazhduar me muaj, CR7 kaloi te Juventus gjatë verës për 100 milionë euro. "Cristiano është më i miri në histori", ka thënë Jorge Mendes për "Tuttosport". "Meritat për transferimin nuk janë të mia, por të Joves dhe Agnellit, i cili vendosi ta transferojë Cristianon. Juve e dëshiroi dhe e bleu, ai tashmë më kishte thënë se dëshiron të luajë për Juventusin në janar, kjo është e vërteta. Mendova se ishte e pamundur, por atij i thash se do të jetë e vështirë, por jo e pamundur. Pastaj takova drejtorët, në takimin e parë isha me (Pavel) Nedvedin dhe (Fabio) Paratiçin, para ndeshjes me Realin. Pastaj takova presidentin dhe nga e pamundura filloja të besoj se po bëhet realitet. Negociatat zgjatën disa muaj", ka shtuar Mendes.

Joshua ofron "çekun e bardhë" për ta bindur Wilderit

Anthony Joshua deklaroi se është gati të bëjë gjithçka në mënyrë që të duelojë ndaj Deontay Wilderit (40 fitore dhe 1 barazim) më 13 prill në "Wembley", në një duel që do të unifikonte në një boksier të vetëm titujt kampionë bote në peshën e rëndë. Wilderi mban titullin e kategorisë WBC në këtë Divizion, i vetmi që i mungon Joshua, që mban titujt e kategorisë IBF, IBO, WBA dhe WBO. "Wilderi është i detyruar të marrë një vendim për të ardhmen, nëse do të duelojë me mua apo dëshiron revanshin. Topi është në fushën e tij, edhe pse e di që ai preferon revanshin me Furyn. Nëse ai zgjedh revanshin unë do t'i shoh alternativat e tjera", u shpreh Anthony Joshua, 22 fitore e asnjë humbje në karrierën e tij. Më tej, boksi britanik ka deklaruar: "Unë e pres të vijë në "Wembley" më 13 prill dhe të arrijmë sa më shpejt marrëveshjen. Jam gati ta paguaj sa ai dëshiron, shumë më tepër nga sa ka fituar deri më tani në karrierën e tij. Do t'i jap shansin të duelojë për t'i fituar edhe katër titujt kampionë bote që kam unë, nëse arrin t'i fitojë".

Bastet zbulojnë favoritët në Ligën e Kampionëve

Pak kanë ndryshuar kuotat e favoritëve për ta fituar Ligën e Kampionëve pas shortit për fazën me eliminim të drejtpërdrejtë. Manchester City, Barcelona dhe Juventus vazhdojnë të jenë mes pretendentëve kryesorë sipas kompanive të basteve. Në rang pretendentësh, Reali i Madridit ka pësuar një humbje kuote teksa shihet si fuqia e pestë e kompeticionit, megjithëse është kampion në fuqi. Guardiola dhe City kuotohen me koeficient 4 nga 4.5 që e kishin përpara shortit, teksa skuadra më e vështirë për t'u shpallur fituese është Schalke, e cila ka një koeficient 251. Barcelona është pretendentja e dytë sipas kompanive të basteve me koeficient fitoreje të trofeut me veshë të gjata 6. E dyta nga fundi është Olimpiku i Lionit me 151 koeficient, ndërsa Ajaxi mbyll podiumin e më pak favoriteve me 101.

	Autor: GAZMEND MORINA		KËNGËTARJA JONË LILA	BYREKU ME LAKRA TË GRIRA	VEGËL MUZIKOR, BORI	LLOJ PAPAGALLI	SILIC	NJËSIA PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS ELEKTRIKE	LUMË NË SHBA E KANADA ME UJËVARA ATRAKTIVE	INTER	EPOKA E RE	BASHKË, ME (bised.)	MIMOZA MUSTAFA	
	QYTET NË SHQIPËRI										TIM MONTGOMERI NË KËTË MOMENT			
	DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË										AKTORI ... HANKS FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO			
	KRIMB TOKE QË VIHET NË MAJË TË GREPIT PËR TË NDJELLË PESHKUN							PRIMITIV FSHATI KU NDODHET AEROPORTI I TIRANËS			◯		MODEJA & AKTORJA E FAMSHME PARAGUAIAINE RIQUELME	
	DUKATI							ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD BASHKËT.			◯		BASHKËT. DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	
	EPOKA E RE	ZANORE EMËR MASHKULLI MYSLIMAN						TRUP GJEOMETRIK USHTRIA			◯			
LLOJ PAPAGALLI							AKTORI I FAMSHËM ROBERT I AFROVA (bised.)			◯		EMI ROSUM PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)		
KLUB I YNI FUTBOLLI										◯				
EPOKA E RE	SHPËRTHIM I FUQISHËM	SHKENCA MBI PAQEN	ISH FUTBOLLISTI KROAT KOVAÇ (BAYERN MUNICH)	↓	FUTBOLLISTI GRANIT BRITMË E LOPËS	ILIRIDA ZANORE	VËLLIMI, SASIA TENISTJA JUSTINE				EMOCIONOH-EM; MË LË MBRESA DIÇKA; MALLËNGJ-EHEM	RADIOLOGY INFORMATION SYSTEM LËRE (bised.)		
MAKINË QË SHNDËRRON ENERGINË MEKANIKE NË ENERGI ELEKTRIKE							FUTBOLLISTI MARTINEZ (B. MUNICH) FLETORË PËR SHËNIME DITORE							QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI PËRGJIGJE NË TELEFON
KITARISTI I FAMSHËM KLEPTON (shq.)						HAPËSIRË E MADHE UJI (shq.) TËRËSIA E NJOHURIVE TË FITUARA; DIJE								KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN AVULL QË DEL NGA TOKA
QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE						FUTBOLLISTI ANTONIO (UDINESE) FUTBOLLISTI YNË FREDERIK (MAN. UTD.)						SHKRONJË GREKE ANNA MICHELLE		
"N" në mes të dy "O"						QYTET NË KOSOVË (pashq.) PUNË A VEPËR MIZORE; KËRDI								JURIST QË JEP NDIHMË PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË I ÇEL
SËMUNDE E RËNDË NGJITËSE (pashq.)			GAZ NATYROR I THJESHTË, PA NGJYRË E PA ERË (shq.) SHTET NË EVROPË											ZANORE FUTBOLLISTI MEHA (shq.)
I ÇMENDUR, I TRANUAR							BANESË E VEÇANTË E GRAVE TË SHEIKËVE GRYKA E VULLKANIT							ERMELINDA MEKSI PRINC ARAB
PUSHKË E GJATË ME PESË FISHEKË							LAPS							FIGURË SHAHU GJAKËS
EPOKA E RE	ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË	PJESË E LIMANIT SËMUNDJA E TUBERKULOZIT				RANCHO PENASQUITOS BASKETBALL KËNGËTARJA MERITA								JETA E QETË DHE E LUMTUR (libr.) GROSETO, IVREA
DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS OSE GJATË LËVIZJES						KAPËRDIJ ISH PIKTORI SHQIPTAR CAPO								MBRET ILIR TOKA E BUKËS
KËNGËTARJA AUSTRALIANE MINOGUE (shqip.)						DJALLI (hebr.) KAFSHË E VOGËL SHTËPIAKE								SHKRIMTARI KELMENDI SHTET NË AZI (pashq.)
ERBIUM, INTENSITET						BOJAXHIU SOCIETY ECONOMIC DYNAMICS								KONFERENCË ME KARAKTER NDERKOMB-ËTAR (shq.) KORNIZË
VRANËSIRË			IRONIA E HIDHUR DY BASHKËTINGËLLORE											DUKURI E RE DY BASHKËTINGËLLORE
IDIOTI, DEBILI														NYJË ALFRED KAÇINARI
DYSHEK I MBUSHUR ME KASHTË QË SHTROHET PRANË VATRËS (shq.)														KAP DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE ANTALYA
														FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN (R. MADRID) BASHKËT.
														SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE, QË NGRIHEN NJËRA MBI TJETRËN

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "MP PHARM 000" Sh.P.K. me seli në Zveqan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 71054438 dhe nr.fiskal:601107627 me pronar Bratislav Todorovic dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MP PHARM 000" D.O.O. Zveqan, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 71054438 broj fiskala: 601107627 Bratislav Todorovic ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MP PHARM 000 " L.L.C in Zveqan, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 71054438i number fiskal: 601107627 Bratislav Todorovic, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Anjisha Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Luciano Motroni " Prizren
- ▶ Erzen Xhabali shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Emin Duraku " Prizren
- ▶ Meriton Morina shpall te pavlefshme dëftesat e vitit X , XI , XII hm " 12 Maji " Ratkoc
- ▶ Bardhosh Ademaj shpall te pavlefshme diplomën shmm " Lorenc Antoni " Prizren
- ▶ Merita Hoti shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren
- ▶ Besim Morina shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAb Prishtine
- ▶ Bedri shehu shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAB Prishtine
- ▶ Ylli Shehu shpall te pavlefshme diplomën e fakultetit Bachelor AAB Prishtine
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronarët që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155\
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjëmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshohet banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshohet me qira banesën e mobiluar te saloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshohet banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshohet banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
(AKPPM)
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale shpall këtë:

K O N K U R S

1. Titulli i punës : Një(1) zyrtar/e për Digitalizimin e Arkives
Referenca : 06/2018
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Drejtori i DABF-së
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Digitalizimi i Arkives në AKPPM

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi i paleve, pranimi i shkresave/dokumentacionit/lendes dhe kontrollimi i tyre mbi validitetin zyrtar
- Regjistrimi i shkresave, parashtrësive dhe kërkesave nga institucionet, zyra e shefit dhe departamentet, divizionet, sektorët në kuadër të AKPPM
- Klasifikimi i dokumentacionit zyrtar dhe mirembajtja e tyre
- Mbajtja e evidencës dhe perkujdesja në programin digjital
- Skanimi i dokumenteve të arkives nga data e kërkuar deri në përditësimin e tij
- Bashkpunimi me kolegjet në arkivë dhe drejtorin e DABF për perfundimin sa më të shpejt të digjitalizimit
- Bashkpunimi me departamentin e IT rreth problemeve të mundshme gjatë skanimit të dokumenteve
- Te jete përgjegjës mbi të gjitha detyrat administrative dhe teknike të dhena dhe të kërkuara nga mbikëqyrësi

Kualifikimi

Diplomë universitare, Shkollë e Mesme + dy (2) vite përvojë punë.

Shkathësitë

Njohuri dhe përvojë substanciale.
Aftësi komunikuese, negociuese.
Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
Shkathësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një grup punë.
Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Formulari për aplikim mund të merret në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtinë), ku edhe dorëzohen pas plotësimit. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00**.
Formulari zyrtar i konkurrencës duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, certifikatën (dëshminë) që s'është nën hetim dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës".

"Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës: 19.12.2018 deri më datën: 26.12.2018 në ora 16:00).

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 512-066
Fax: +381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
(AKPPM)
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
Kosova Medicines Agency (KMA)



Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, br. 03/L-149 i Uredbe br.02/2010 za procedure zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosova, Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva objavljuje:

K O N K U R S

1. Naziv radnog mesta: Jedan (1) službenik za digitalizaciju arhive
Referenca : 06/2018
Vrsta pozicije : Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci
Radno vreme : 40 sati nedeljno
Nadzornik : Direktor DABF
Mesto : KALMS-Prishtina

Svrha radnog mesta:

Digitalizacija arhive KALMS

Zadaci i odgovornosti:

- Prihvatanje stranaka, primanje dokumenata / dokumentacije / slučaja i njihovu kontrolu nad službenom valjanosti
- Registracija dokumenata, podnesaka i zahtjeva od institucija, sjedišta i odjela, odjela sektora unutar KALMS
- Razvrstavanje službene dokumentacije i njihovo održavanje
- Čuvanje dokaza i brigu o digitalnom programu
- Skeniranje arhivskih dokumenata od traženog datuma do ažuriranja
- Saradivati s kolegama iz arhiva i direktorom Budžeta i Administracije za najbrži završetak digitalizacije
- Saradujte s IT odjelom o potencijalnim problemima tijekom skeniranja dokumenata
- biti odgovoran za sve administrativne i tehničke dužnosti koje je podnio i zatražio nadzornik

Kvalifikacije

Univerzitetska Diploma, srednja škola + dvije (2) godine radnog iskustva.

Veštine

Znanje i osnovno iskustvo.
Veštine komuniciranja i pregovaranja.
Veštine u određivanju ciljeva, radnog planiranja i analize.
Veštine za timsko organizovanje, sposobnost da upravlja sa jednim ili više radnih grupa.
Računarske veštine sa softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access).

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Obrazac za aplikaciju može se dobiti u Kosovskoj Agenciji za Lekove i Medicinska Sredstva, kancelarija Ljudskih Resursi, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtina), gde mogu se dostaviti posle popunjavanja obrazaca. Za detaljnije informacije možete kontaktirati sa kancelarijom Humanih Resursa u broj telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00**.

Službeni obrazac za konkurisanje treba da se dostavi zajedno sa dokazom o školskoj kvalifikaciji, završeni tečajevi, radno iskustvo, sertifikat (dokaz) da nije pod istragom i dve referencije. Upotreba pogrešnog i nekompletiranog obrazca sa potrebnim podacima smatrat će se nevažećim.

"Civilna Služba Republike Kosove pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje aplikacije od muškaraca i žena od svih zajednica Republike Kosova".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljeno pravedno i proporcionalno u organima civilne službe Javne Administracije na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno u Čl.11, stav 3 Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova".

Aplikacije poslate poštom, koja nose poštanski žig na pošiljci na poslednji dan roka za podnošenje aplikacije, smatrat će se važećim i biće uzete u obzir ako stigne u roku od 3 dana. Prijave koje pristiglu nakon tog roka neće biti razmatrane uopšte.

Kandidati koji budu ušli u uži izbor za intervju bit će obavešteni pismenim putem ili putem telefona u zakonskom roku od strane personela.

Rok za konkurs je otvoren 8 dana od dana objavljivanja u novinama (od datuma: 19.12.2018 do datuma: 26.12.2018 u 16:00).

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 512-066
Fax: +381 (0) 38 512-243
www.akpm-rks.org

FITO 2 SUPER muaj FALAS me SuperDUO!

Abonohu në ndonjërin nga pakot **SuperDUO** dhe paguaj vetëm 10 muaj, ndërsa 2 të fundit merri **FALAS**. Përveç kësaj, fiton edhe **3 SIM kartela me 3 muaj komunikim FALAS** brenda rrjetit të IPKO-së. Pagesa mund të bëhet në baza mujore.

Pakot e **SuperDUO** janë pakot më të kompletuara në treg. Ato ofrojnë internet mbi **50Mbps** dhe përmbajtje mbi **150 kanale televizive** me të gjitha ligat më emocionuese të futbollit (Premier League, Serie A, La Liga), si dhe kanalet sportive më të popullarizuara botërore.

ÇKA O' SUPER O' SUPER!

Merr ofertën në dyqanin më të afërt të IPKO-së.

*Nxito, oferta është promovionale.

WWW.IPKO.COM

